



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PERFORMANCE

“Mbrojtja dhe siguria e digave”

Janar 2026

Shënim: Ky auditim është kryer në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës.

P Ë R M B A J T J A

PËRMBLEDHJA	4
1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	5
1.1 Konteksti i problemit social	5
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës	6
2. SUBJEKTET NËN AUDITIM	6
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim	6
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	8
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit	9
2.4 Pesha në buxhet	12
2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore.....	16
3. DETAJET E AUDITIMIT	16
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	16
3.2 Objektivi i auditimit.....	17
3.3 Pyetjet e auditimit	17
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....	18
4. SHJTELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT	18
4.1 A garanton kuadri ligjor e rregullator një mbikëqyrje të duhur e të plotë lidhur me sigurinë e digave?.....	19
4.1.1 A kanë hartuar dhe miratuar institucionet përgjegjëse politika të duhura për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e digave?	19
4.1.2 A garanton struktura organizative aktuale mbikëqyrje të duhur mbi sigurinë e digave?.....	28
4.2 A kanë marrë institucionet përgjegjëse masa organizative, teknike dhe financiare me qëllim shfrytëzimin normal të digave?.....	36
4.2.1 A ka rezultuar efektiv kontrolli, monitorimi dhe raportimi lidhur me sigurinë e digave?.....	36
4.2.2 Çfarë masash janë marrë lidhur me përmirësimin e gjendjes teknike të digave?	52
5. ANEKSET	Error! Bookmark not defined.

AKRONIMET

RSH	Republika e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
NJVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendimi i Këshillit Bashkiak
INTOSAI	The International Organization of Supreme Audit Institutions
EUROSAI	The European Organisation of Supreme Audit Institutions
ISSAI	International Standards of Supreme Audit Institutions
KKDM	Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha
SKDM	Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha
ITD	Inspektorati Teknik i Digave
ICOLD	International Commission on Large Dams (Komisioni Ndërkombëtar i Digave të Mëdha)
HEC	Hidrocentral
DUK	Drejtori e Ujitje-Kullimit

PËRMBLEDHJA

Auditimi i performancës për mbrojtjen dhe sigurinë e digave u realizua pranë institucioneve shtetërore të ngarkuara me garantimin e sigurisë së digave, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha dhe strukturat e tij ndihmëse (Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha – SKDM, Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave – KTPD, Inspektorati Teknik i Digave – ITD), si edhe disa shfrytëzues të disa prej digave më të rëndësishme të vendit si Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkia Tiranë dhe Bashkia Berat. Pjesë e këtij auditimi ka qenë edhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e institucionit që mbulon shpenzimet e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha, SKDM – së, KTPD – së dhe ITD- së dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Objekti i këtij auditimi ishte vlerësimi sa i takon masave të marra nga ana e institucioneve përgjegjëse me qëllim përmirësimin e gjendjes së digave, për periudhën e auditimit 2021 – 2024.

Gjatë këtij auditimi Kontrolli i Lartë i Shtetit evidentoi se institucionet shtetërore për mbikëqyrjen dhe kontrollin e digave në Shqipëri nuk kanë vlerësuar gjendjen e të gjitha digave në vendin tonë dhe nuk kanë marrë masat e duhura për përmirësimin e gjendjes së tyre.

Kuadri ligjor e rregullator nuk garanton një mbikëqyrje të plotë për të gjitha digat duke lënë jashtë vëmendjes digat e vogla. Objekt i veprimtarisë së KKDM-së kanë qenë kryesisht digat e mëdha (rreth 350), ndërkohë që legjislacioni nuk i përjashton digat e vogla (rreth 300) nga fushëveprimi i tij. KKDM, SKDM, KTPD dhe ITD nëpërmjet veprimtarisë së tyre nuk kanë garantuar mbulim dhe mbikëqyrje të plotë dhe efektiv të të gjitha digave në vendin tonë. Kontrolli, monitorimi dhe raportimi mbi gjendjen dhe sigurinë e digave vuan mungesën e ngritjes dhe funksionimit të të gjitha strukturave mbikëqyrëse, sistemeve të monitorimit dhe raportimit jo të plotë e të qartë.

Edhe pse janë kryer disa investime rehabilitues në 43 diga të ndryshme, ka munguar vëmendja institucionale dhe investime të qëndrueshme për përmirësimin e sigurisë së digave. Bashkia Tiranë dhe Berat nuk kanë pasur qasje pro aktive në gjurmimin dhe përthithjen e fondeve të ndryshme për të realizuar projekte rehabilituese në digat që kanë në administrim.”

Për sa më sipër, Kontrolli i Lartë i Shtetit u ka rekomanduar institucioneve përkatëse marrjen e masave për të rishikuar e përditësuar kuadrin ligjor e rregullator sa i takon, garantimit të një mbikëqyrjeje e mbulim të plotë për të gjitha digat e mëdha e të vogla të vendit tonë, reformatimit organizativ të KKDM – së dhe strukturave mbështetëse të tij, klasifikimit të digave sipas nivelit të rrezikshmërisë që ato përfaqësojnë dhe parashikimit të distancave të sigurisë nga digat. Gjithashtu, nëpërmjet këtij auditimi i është rekomanduar institucioneve që kanë diga në shfrytëzim/administrim të marrin masa për të rritur angazhimin financiar në drejtim të mbrojtjes dhe sigurisë së digave, në veçanti nëpërmjet aplikimeve për të përfituar fonde nga buxheti i shtetit dhe/ose nga financime të huaja. Po kështu, në rekomandimet e këtij auditimi është theksuar nevoja për kryerjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës të gjendjes aktuale të digave, si një parakusht për një parashikim të mirëfilltë e të saktë të ndërhyrjeve rehabilituese në digat e vendit tonë.

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i problemit social

Në kohët e lashta, digat ndërtoheshin për qëllimin e vetëm të furnizimit me ujë ose vaditjes. Me zhvillimin e qytetërimeve, kishte një nevojë më të madhe për furnizimin me ujë, ujitje, kontrollin e përmbytjeve, lundrimin, cilësinë e ujit, kontrollin e sedimenteve dhe energjinë. Një digë është gur themeli në zhvillimin dhe menaxhimin e zhvillimit të burimeve ujore të një pellgu lumor. Kërkesa për ujë po rritet vazhdimisht në të gjithë botën. Nuk ka jetë në tokë pa ujë, burimi ynë më i rëndësishëm përveç ajrit dhe tokës. Burimet e ujërave të ëmbla janë të kufizuara dhe të shpërndara në mënyrë të pabarabartë. Në vendet me konsum të lartë me burime të pasura dhe një infrastrukturë teknike shumë të zhvilluar, mënyrat e shumta të ruajtjes, riciklimit dhe ripërdorimit të ujit mund të mjaftojnë pak a shumë për të frenuar rritjen e mëtejshme të furnizimit. Në shumë rajone të tjera, megjithatë, disponueshmëria e ujit është kritike për çdo zhvillim të mëtejshëm, madje edhe për mbijetesën e thjeshtë të komuniteteve ekzistuese ose për të plotësuar kërkesën në rritje të vazhdueshme që vjen nga rritja e shpejtë e popullsisë së tyre. Në këto rajone njeriu nuk mund të heqë dorë nga kontributi që duhet të japin digat dhe rezervuarët për shfrytëzimin e burimeve ujore.

Shumica e digave në botë janë diga për një qëllim, por tani ka një numër në rritje të digave me shumë qëllime. Referuar Regjistrit Botëror të Digave, ujitja është deri tani qëllimi më i zakonshëm i digave. Ndër digat me një qëllim, 48% janë për ujitje, 17% për hidroenergji (prodhimi i energjisë elektrike), 13% për furnizim me ujë, 10% për kontrollin e përmbytjeve, 5% për rekreacion dhe më pak se 1% për lundrim dhe kultivim peshku.¹

Në Shqipëri aktualisht janë 350 diga të mëdha dhe afro 300 diga të vogla duke e renditur vendin tonë ndër 6 vendet e para në Evropë dhe ndër 20 vendet e para në botë me numrin total më të madh të digave të mëdha. Shqipëria është vendi që ka më shumë diga të mëdha në botë për frymë dhe për 1000 km². Për vetë rëndësinë ekonomike dhe riskun e lartë që kane digat në rast prishje të mundshme të tyre apo të përmbytjeve nga reshjet e mëdha është e domosdoshme mirëmbajtja, monitorimi, kontrolli dhe rritjen e sigurisë së tyre. Territori hidrografik i Shqipërisë ka një sipërfaqe prej 44 000 km² ose 57 % më shumë se territori shtetëror i vendit. Në territorin hidrografik të vendit tonë bien afro 1400 mm reshje në vit. Afro 40 % e prurjeve mesatare të ujit të lumenjve dhe përrenjve të vendit tonë përdoren për prodhim energjie ujore dhe më pak se 700 milion m³ ujë përdoren për ujitje të tokave bujqësore. Një rol shumë të rëndësishëm në administrimin e këtyre ujërave luajnë 350 digat e mëdha të ndërtuara kryesisht në vitet 1960 - 1990 të cilat përdoren për prodhimin e energjisë ujore, furnizimit me ujë të pijshëm, ujitjet e tokave bujqësore, mbrojtjen nga përmbytjet, rritjen e peshkut, transportin ujqor, turizëm dhe zhvillimin urban.²

Me përjashtim të digave për prodhim hidroenergjie të ndërtuara në lumenjtë Drin, Devoll dhe Mat, digat e tjera në përgjithësi nuk monitorohen dhe nuk mirëmbahen nga shfrytëzuesit e digave sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi duke sjellë jo vetëm përkeqësim të gjendjes së tyre por edhe mungesë të njohjes reale të situatave aktuale si dhe krijimin e problemeve të panjohura për zonat urbane poshtë tyre. Kjo situatë është më problematike në digat që përdoren dhe janë në pronësi të bashkive të vendit të cilat kanë treguar gjatë një neglizhencë në mirëmbajtjen dhe monitorimin e tyre. Në këto bashki vërehen edhe probleme të mëdha që lidhen me mungesën e inxhinierëve dhe njësive të kontrollit teknik të digave. Nga Kontrolli dhe Inspektimi i digave të mëdha gjatë vitit 2023 rezulton se rreth 30 diga të mëdha dhe rreth 90 diga të vogla janë jashtë funksionit.³

¹ https://www.icold-cigb.org/GB/dams/role_of_dams.asp

² KKDM - Raporti vjetor për gjendjen, shfrytëzimin, monitorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave të mëdha dhe dambave në Shqipëri, 2023, fq 3.

³ KKDM - Raporti vjetor për gjendjen, shfrytëzimin, monitorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave të mëdha dhe dambave në Shqipëri, 2023, fq 6.

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficientia dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me mbrojtjen dhe sigurinë e digave në vendin tonë duke synuar që të adresojë shkaqet kryesore që çojnë në gjendjen jo të mirë të tyre.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Auditimi i performancës për mbrojtjen dhe sigurinë e digave është një auditim i një rëndësie të veçantë për vendin tonë, pasi në Shqipëri ka një numër të lartë digash dhe burimesh ujore. Në Shqipëri, përgjegjësia për mbrojtjen dhe sigurinë e digave është e shpërndarë midis shumë institucioneve të cilat sipas roleve specifike që kanë në proces kanë edhe detyrime të veçanta. Vlen të theksohet se një përgjegjësi të veçantë mbajnë shfrytëzuesit e këtyre veprave si edhe institucionet shtetërore të cilat ushtrojnë kontrollin e shtetit mbi mbrojtjen dhe sigurinë e digave. Në këtë paragraf të programit të auditimit prezantohen shkurtimisht subjektet e auditimit duke përshkruar funksionin dhe rolin e tyre në këtë proces.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë MIE ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e infrastrukturës dhe transportit, përfshirë edhe atë me tubacione për ujësjellës - kanalizimet dhe bashkërendimin e politikave të infrastrukturës së mbetjeve urbane, në komponentin zbatues të tyre, ndjekjen e zbatimit e këtyre politikave në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, në sektorin e telekomunikacionit e shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë jo - ushqimore. Në mbështetje të ligjit nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” kreu II “Organet shtetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e digave/dambave” neni 4, MIE përcakton mjediset e punës si dhe përballon me fondet buxhetore shpenzimet dhe pagat që nevojiten për të mbuluar veprimtarinë e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (më tej KKDM), Institutit të Projekteve të Teknologjisë së Digave (më tej IPTD), Sekretariatit Teknik të Digave të Mëdha (më tej STDMD) dhe Inspektoratit Teknik të Digave (më tej ITD). Gjithashtu MIE kryen pagesën e tarifës vjetore të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (më tej ICOLD).⁴

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), është një organ kolegjal i Këshillit të Ministrave, i cili ushtron kontrollin e shtetit për sigurinë e digave/dambave si vepra të një rëndësie të veçantë dhe përfaqëson shtetin shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Digave

⁴ Urdhër i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 469, datë 30.12.2021 “Për Miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, neni 3.

të Mëdha (ICOLD). Ky organ, ndër të tjera, është përgjegjës për kontrollin fizik dhe dokumentar, verifikues në digat/dambat gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të tyre.⁵

Sekretariati Teknik i Digave të Mëdha

Në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë funksionon Sekretariati Teknik i Digave të Mëdha, si një zyrë ekzekutive e KKDM – së, e cila ndjek veprimtarinë kontrolluese të projektimit, ndërtimit dhe shfrytëzimit të digave dhe dambave. Ky Sekretariat ka të drejtë të ushtrojë kontroll në institucionet, që administrojnë digat dhe dambat, si dhe të përgatisë propozime të akteve ligjore dhe nënligjore në këtë fushë.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

AKBN është institucion varësi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila ka për mision, ndër të tjera, zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimin racional të burimeve natyrore në bazë të politikave qeverisëse. Gjithashtu, AKBN monitorim shfrytëzimin e këtyre burimeve në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjistik. Kjo agjenci kryen monitorimin e HEC – ve të ndërtuara në vendin tonë një pjesë e të cilave kanë edhe diga, ndaj dhe kjo është arsyeja e përfshirjes së këtij institucioni në këtë auditim.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

MBZHR ka për mision të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe rural, përmes menaxhimit efikas të burimeve natyrore, rritjes së prodhimtarisë, përmirësimit të infrastrukturës bujqësore dhe përmirësimit të cilësisë së jetës në zonat rurale. Në përmbushje të këtij misioni, MBZHR luan një rol të rëndësishëm edhe në garantimin e sigurisë së digave që shërbejnë për ujitje, kullim dhe menaxhim të burimeve ujore në funksion të bujqësisë. Përmes strukturave të saj qendrore dhe vendore, ministria është përgjegjëse për mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe monitorimin e digave bujqësore, si dhe për mbështetjen e bashkive dhe organizatave të përdoruesve të ujit (OBU-ve) në administrimin e tyre. Siguria e këtyre veprave ujore është thelbësore për mbrojtjen e prodhimit bujqësor dhe të zonave rurale, duke u lidhur ngushtësisht me objektivat strategjikë të MBZHR për zhvillim rural të qëndrueshëm dhe menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Bashkitë

Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përgjegjëse për administrimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e digave që u janë transferuar në pronësi ose administrim, veçanërisht atyre që shërbejnë për ujitje, kullim dhe mbrojtje nga përmytjet. Në zbatim të legjislacionit për vetëqeverisjen vendore dhe menaxhimin e burimeve ujore, ato duhet të vlerësojnë gjendjen teknike të këtyre veprave, të parashikojnë fonde për ndërhyrje, të bashkëpunojnë me organizatat e përdoruesve të ujit dhe të hartojnë plane emergjence në rast rreziku, me qëllim mbrojtjen e komunitetit dhe garantimin e funksionalitetit të infrastrukturës ujore lokale.

Bashkitë e përzgjedhura në këtë auditim janë:

Bashkia Tiranë, e cila është përgjegjëse për shfrytëzimin e 39 digave, ndër të cilat përfshihen edhe Diga e Bovillës dhe ajo e Liqenit të Artificial të Tiranës. Këto dy diga janë menduar që të përfshihen si raste studimore nga grupi i auditimit për shkak të rëndësisë dhe situatës në të cilën ato ndodhen. Kujtojmë këtu, se portat e shkarkimit të digës së liqenit të Tiranës janë të dëmtuara prej vitesh dhe nuk funksionojnë.

Bashkia Berat, e cila është përgjegjëse për shfrytëzimin e 9 digave.

⁵ Ligji nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”, neni 4.

2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

Kritere politike:

- Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2019 – 2021;
- VKM nr. 94, datë 22.03.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023 - 20230”

Kritere teknike:

- Ligji nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”;
- Ligji nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”;
- Ligji 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”
- Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- VKM nr. 480, datë 31.07.2018, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018 – 2030”;
- VKM nr. 547, datë 09.08.2006, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare së Burimeve Natyrore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 575, datë 10.07.2013, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”;
- VKM nr. 822, datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”;
- VKM nr. 168, datë 24.03.2023, “Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror”;
- VKM nr. 278, datë 08.05.2003, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Komitetit Kombëtar të Digave të mëdha”;
- VKM nr. 406, datë 19.06.2019, “Për strukturat e Komitetit Kombëtar të Digave”;
- VKM nr. 1108, datë 30.12.2015, “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe administrimit të ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”;
- VKM nr.147, datë 18.03.2004, “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”;
- Udhëzim nr. 4, datë 18.07.2003 “Kërkesat e dokumentacionit ligjor dhe teknik që duhet të përmbajë dosja e digave dhe e dambave”;
- Udhëzim i përgjithshëm mbi përgatitjen e planeve të gatishmërisë në rastet e emergjencave civile të shkaktuara nga aktiviteti i shfrytëzimit të digave”;
- Udhëzim i përgjithshëm mbi dosjen teknike/pasaporta e digave;
- Udhëzim i përgjithshëm mbi “hartimin e rregullores teknike të shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe kontrollit të objektit dhe nën objektit të digave të mëdha”;
- Rregullore e monitorimit të digave pas tërmetit;
- Rregulloret e brendshme të institucioneve subjekt auditimi,

Kriteret e monitorimit dhe raportimit:

- Raporte vjetore të KKDM-së;
- Raporte kontrolli kryer nga shfrytëzuesit e digave;
- Raporte Monitorimit të HEC-eve të kryera nga AKBN;
- Raporte Inspektimi të kryera nga Inspektorati Teknik i Digave.

Praktikat e mira:

- Raport Auditimi i Zyrës së Kontrollorit të Shtetit të New York – ut, “Selected Aspects of the Dam Safety Program”, 2006.⁶
- Funksionimi dhe organizimi i “*Direzione generale per le dighe e le infrastrutture idriche*”, strukturë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit i Italisë.

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, garantimin e sigurisë publike dhe respektimin e angazhimeve shtetërore brenda dhe jashtë vendit. Përmes funksioneve të saj, MIE harton dhe zbaton politika në sektorë kyç si infrastruktura rrugore dhe energjetike, transporti, telekomunikacioni, shërbimi postar, industria jo-ushqimore, ujësjellës-kanalizimet, siguria e digave etj. Këto politika ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, sigurimin e furnizimit me energji, rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike dhe zhvillimin urban të qëndrueshëm. Një aspekt i rëndësishëm i punës së MIE lidhet me sigurinë e digave, një çështje që ka ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe mjedisit. Ministria përballon nga fondet buxhetore veprimtarinë e strukturave të specializuara si Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), Instituti i Projekteve të Teknologjisë së Digave (IPTD), Sekretariati Teknik i Digave (STDM) dhe Inspektorati Teknik i Digave (ITD), duke garantuar projektimin, ndërtimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e tyre në përputhje me standardet teknike dhe ligjore. MIE gjithashtu siguron pjesëmarrjen e Shqipërisë në rrjetin ndërkombëtar të sigurisë së digave përmes pagesës së tarifës vjetore të anëtarësimit në Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD), duke e pozicionuar vendin tonë në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe duke mundësuar shkëmbimin e ekspertizës teknike. Në tërësi, produktet e MIE janë thelbësore për zhvillimin infrastrukturor dhe industrial të vendit, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe përforsimin e kapaciteteve institucionale që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën ekonomike dhe sociale të qytetarëve.

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Sekretariati Teknik i Digave të Mëdha luajnë një rol kyç në sigurimin e integritetit të veprave hidrike, administrimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe përmbushjen e angazhimeve shtetërore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. KKDM, si organ kolegjal i Këshillit të Ministrave, ushtron kontrollin shtetëror mbi digat dhe dambat, duke garantuar që këto vepra strategjike të ndërtohen dhe të shfrytëzohen në përputhje me standardet më të larta të sigurisë teknike dhe ligjore. Përmes inspektimeve fizike dhe verifikimeve dokumentare në fazën e ndërtimit dhe të shfrytëzimit, KKDM luan një rol vendimtar në parandalimin e rreziqeve që mund të shkaktojnë përmytje, dëme materiale apo humbje njerëzore. Po ashtu, përfaqësimi i Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD) nga ana e këtij komiteti siguron përfshirjen e vendit në rrjetin global të ekspertizës dhe përputhjen me praktikën më të avancuar në këtë fushë. Nga ana tjetër, **Sekretariati Teknik i Digave të Mëdha**, që funksionon pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ka një rol ekzekutiv dhe operativ në mbështetje të punës së KKDM-së. Ky sekretariat ndjek dhe mbikëqyr nga afër proceset teknike të projektimit, ndërtimit dhe funksionimit të digave, duke ushtruar kontroll në institucionet përgjegjëse për administrimin e tyre. Ai përgatit gjithashtu propozime për akte ligjore dhe nënligjore, duke ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit rregullator dhe institucional në këtë fushë. Produktet e këtij sekretariati – që përfshijnë raporte kontrolli, rekomandime teknike, dhe akte normative – janë të domosdoshme për sigurimin e integritetit strukturor të digave, ruajtjen e jetës njerëzore dhe

⁶ <https://web.osc.state.ny.us/audits/allaudits/093008/06s61.pdf>

mbrojtjen e mjedisit, si dhe për garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të këtyre veprave të rëndësishme për ekonominë dhe furnizimin me ujë e energji.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) është një ndër institucionet qendrore që kontribuon në menaxhimin strategjik të burimeve natyrore, me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri. Si institucion në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, AKBN ka për mision të sigurojë menaxhimin e përgjegjshëm dhe efikas të burimeve natyrore të Shqipërisë, në përputhje me politikat qeveritare dhe standardet teknike. Përmes funksioneve të saj të zhvillimit dhe mbikëqyrjes, agjencia ndikon drejtpërdrejt në shfrytëzimin racional të pasurive natyrore në sektorët minerar, hidrokarbur dhe energjetik – sektorë që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të ekonomisë kombëtare dhe burimeve të ardhurash për buxhetin e shtetit. Një aspekt veçanërisht i rëndësishëm i punës së AKBN është monitorimi i veprimtarisë së hidrocentraleve (HEC) të ndërtuara në territorin shqiptar. Kjo përfshin vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me parametrat teknikë dhe kontraktualë, si dhe mbikëqyrjen e ndikimeve që ato mund të kenë në mjedis dhe në komunitetet përreth. Këto monitorime janë të domosdoshme për të garantuar sigurinë e veprave hidrike, për të parandaluar dëmtimet strukturore ose mjedisore dhe për të siguruar që shfrytëzimi i burimeve ujore për prodhimin e energjisë të bëhet në mënyrë të përgjegjshme dhe në interes të zhvillimit të qëndrueshëm. Produktet e AKBN-së si raportet teknike, vlerësimet e zbatimit të kontratave, analizat e ndikimit dhe rekomandimet për përmirësim – përbëjnë një bazë të rëndësishme për marrjen e vendimeve të informuara nga ana e institucioneve publike, si dhe për forcimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë në menaxhimin e burimeve natyrore të vendit.

Roli dhe kontributi i **Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)** është vendimtar për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe për përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale. Si institucion përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave bujqësore dhe rurale, MBZHR ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e prodhimit, menaxhimin efikas të burimeve natyrore dhe zhvillimin e infrastrukturës bujqësore – elementë kyç për qëndrueshmërinë ushqimore dhe mbrojtjen e ekonomisë rurale përballë sfidave si ndryshimet klimatike. Një komponent thelbësor i misionit të saj është menaxhimi dhe siguri i qëndrueshmërisë së digave dhe infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, që luajnë një rol kritik për furnizimin me ujë për vaditje, mbrojtjen nga përmytjet dhe ruajtjen e tokave bujqësore. Këto struktura janë jetike për mirëfunksionimin e sistemit bujqësor, dhe mirëmbajtja e tyre garanton si produktivitetin e fermerëve, ashtu edhe sigurinë e mjedisit dhe komuniteteve rurale.

Pas vitit 2016, në zbatim të VKM nr. 1108, datë 30.12.2015, një pjesë e konsiderueshme e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, së bashku me asetet dhe personelin, iu transferua bashkive, ndërsa MBZHR mbajti në administrim kanalet kryesore ujitëse e kulluese, hidrovoret dhe veprat strategjike të mbrojtjes nga përmytjet. Në vitin 2017, Ligji nr. 24/2017 “Për Administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit” e përcaktoi MBZHR si organin kryesor politik për këtë fushë, ndërsa zbatimi në terren realizohet përmes bashkive, organizatave të përdoruesve të ujit (OPU-ve) dhe katër Drejtorive të Ujitjes dhe Kullimit (DUK) me bazë rajonale.

Nëpërmjet DUK Lezhë, DUK Durrës, DUK Fier dhe DUK Korçë, ministria është aktualisht përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë së 7 ujëmbledhësve me gjithsej 9 diga, të shpërndarë në qarqe të ndryshme të vendit. Këto janë struktura me rëndësi strategjike, të cilat mbrojnë zona të gjera bujqësore dhe mbështesin qindra fermerë. Secila DUK ushtron funksionet e saj sipas rajoneve përkatëse, duke menaxhuar digat dhe ujëmbledhësit në bashki si Bulqizë, Lushnjë, Roskovec, Gjirokastrë, Berat dhe Shkodër.

Produktet e veprimtarisë së MBZHR-së, si planet kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, programet e rehabilitimit të infrastrukturës, udhëzimet teknike dhe raportet e

monitorimit, janë thelbësore për të siguruar integritetin e sistemeve ujore, për të mbrojtur prodhimin bujqësor dhe për të garantuar siguri e qëndrueshmëri në zonat rurale. Po ashtu, MBZHR luan një rol mbështetës ndaj bashkive dhe OPU⁷-ve nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve vendore dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional. Këto ndërhyrje dhe produkte janë të lidhura ngushtë me objektivat strategjike të ministrisë, që synojnë zhvillimin e qëndrueshëm rural, ruajtjen e burimeve natyrore dhe fuqizimin e komuniteteve bujqësore përmes një qasjeje të integruar ndaj menaxhimit të burimeve ujore dhe sigurisë infrastrukturore.

Bashkia Tiranë luan një rol vendimtar në sigurimin e infrastrukturës së digave në territorin e saj, duke qenë ndër bashkitë me përgjegjësi më të larta në nivel kombëtar për shkak të numrit të madh dhe funksioneve kritike të veprave që administron. Aktualisht, ajo ka nën administrim 39 diga, përfshirë Digën e Bovillës dhe atë të Liqenit Artificial, të cilat janë thelbësore për furnizimin me ujë të kryeqytetit dhe për mbrojtjen nga përmbytjet. Rëndësia e produkteve të punës së Bashkisë dhe strukturave të saj teknike është evidente në kapacitetin për të parandaluar rreziqe të mëdha për shëndetin publik, mjedisin dhe ekonominë vendore. Për shembull, gjendja e amortizuar e portave të shkarkimit të digës së Liqenit të Tiranës, që prej vitesh janë jashtë funksionit, kërkon një ndërhyrje emergjente, e cila mund të arrihet vetëm përmes një plani teknik të detajuar dhe të financuar.

Transferimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nga Ministria e Bujqësisë të bashkitë, në zbatim të VKM nr. 1108, datë 30.12.2015, ka vendosur Bashkinë Tiranë në pozitën e përgjegjshme ligjore dhe funksionale për mirëmbajtjen dhe administrimin e rezervuarëve. Me VKB nr. 28, datë 23.05.2016, kjo përgjegjësi është deleguar Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, e cila, përmes strukturës së saj specifike – Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale – ka ngritur Njësinë e Drejtimit Teknik për mbikëqyrjen e digave. Produktet e punës së kësaj Njësie janë thelbësore për menaxhimin e rrezikut dhe parandalimin e emergjencave, pasi ajo kryen kontrollin teknik periodik të digave, harton raportet përkatëse, monitoron nivelin e ujit në ujëmbledhës dhe evidenton problematikat teknike që mund të çojnë në situata të rrezikshme. Këto kontrole realizohen sidomos përpara sezonit të shirave, duke përfshirë vlerësimin e shkallës së amortizimit të elementeve strukturorë dhe përcaktimin e masave parandaluese. Megjithatë, ndonëse puna monitoruese dhe dokumentuese është e vazhdueshme, mungesa e fondeve ka ndikuar në realizimin e produkteve më të avancuara analitike, si studimi gjithëpërfshirës mbi nivelin e rrezikshmërisë së digave në territorin e Bashkisë. Pavarësisht kësaj, janë përgatitur detyra projektimi për 12 diga, të cilat synojnë rikonstruksionin e elementeve teknikë dhe janë shoqëruar me hartimin e projekteve teknike nga Bashkia Tiranë, me qëllim sigurimin e financimeve për zbatimin e tyre. Këto dokumente përbëjnë një bazë të rëndësishme për planifikimin strategjik dhe përfshijnë në mënyrë të strukturuar vlerësimin teknik, prioritizimin e ndërhyrjeve dhe projektimin e masave për sigurinë afatgjatë të digave.

Bashkia Berat, me nëntë diga nën administrim, mban një rol të rëndësishëm në garantimin e funksionalitetit dhe sigurisë së këtyre veprave hidrike, të cilat janë thelbësore për mbrojtjen nga përmbytjet dhe furnizimin bujqësor me ujë. Si pjesë e detyrimeve të saj ligjore për mirëmbajtjen dhe administrimin e infrastrukturës së ujitjes e kullimit, Bashkia ka krijuar një strukturë të dedikuar – Drejtorinë e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar – e cila përmes sektorit Ujitje-Kullim është përgjegjëse për monitorimin dhe inspektimin periodik të digave. Produktet e punës së kësaj strukture janë të domosdoshme për menaxhimin teknik dhe institucional të digave. Çdo vit, Drejtoria harton një dokument të detajuar: “Raporti i Monitorimit, Shfrytëzimit, Mirëmbajtjes dhe Sigurisë së Digave dhe Dambave”, i cili përmbledh të dhëna mbi gjendjen fizike dhe funksionale të

⁷ Organizatat e përdoruesve të ujit.

digave, ndërhyrjet e kryera, nevojat e evidentuara dhe rekomandimet për përmirësim. Këto raporte vjetore – të hartuara rregullisht nga viti 2021 deri në vitin 2024 – përbëjnë një mjet të vlefshëm për planifikim dhe përgjegjshmëri institucionale. Për të siguruar një nivel të lartë kontrolli, dy punonjës të ngarkuar posaçërisht kryejnë inspektime të rregullta javore në të gjitha digat, duke monitoruar elementët kritikë teknikë. Çdo ditë të hënë, ata përgatisin raporte individuale për secilën digë, të cilat shërbejnë si bazë për veprimet pasuese administrative dhe teknike. Kjo praktikë e sistemuar e inspektimit dhe raportimit kontribuon ndjeshëm në identifikimin në kohë të problematikave dhe në reduktimin e rreziqeve të mundshme për komunitetin dhe mjedisin përreth. Në këtë kuadër, produktet e bashkive – si raportet e inspektimeve, projektet e ndërhyrjeve, planet e emergjencës dhe marrëveshjet me organizatat e përdoruesve të ujit – janë thelbësore jo vetëm për sigurimin e infrastrukturës ekzistuese, por edhe për ndërtimin e besimit të komunitetit tek institucionet vendore. Këto dokumente dhe veprime konkrete pasqyrojnë angazhimin e bashkive për të ruajtur dhe zhvilluar një menaxhim efektiv dhe të qëndrueshëm të burimeve ujore dhe të infrastrukturës që lidhet me to.

2.4 Pesha në buxhet

Në këtë paragraf do të trajtohen vetëm subjektet, të cilat kanë fonde të alokuara në lidhje me mbrojtjen dhe sigurinë e digave. Në vitin 2021, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka realizuar shpenzime korrente në masën 482,950 mijë lekë dhe shpenzime kapitale në vlerën 30,121 mijë lekë, me një total prej 513,071 mijë lekë. Në vitin 2022, shpenzimet korrente ishin 465,664 mijë lekë dhe kapitale 69,953 mijë lekë, duke çuar totalin në 535,617 mijë lekë. Në vitin 2023, të dy kategoritë e shpenzimeve ishin në nivele minimale – vetëm 1,564 mijë lekë për shpenzimet korrente dhe 4 mijë lekë për ato kapitale, me një total vjetor prej 1,568 mijë lekë. Ndërsa në vitin 2024, është shënuar një rritje e ndjeshme, me 1,282,722 mijë lekë në shpenzime korrente dhe 16,313 mijë lekë në shpenzime kapitale, duke arritur një total prej 1,299,034 mijë lekë.

Tab. nr. 1. Shpenzimet korrente - kapitale të MIE (fakti) për periudhën 2021 – 2024
(në 000/lekë)

Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë	Fakti 2021	Fakti 2022	Fakti 2023	Fakti 2024
Shpenzime Korrente	482,950	465,664	1,564	1,282,722
Shpenzime Kapitale	30,121	69,953	4	16,313
TOTAL	513,071	535,617	1,568	1,299,034

Burimi: MIE

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) ka përfituar fonde të cilat lidhen me honorarët për mbledhjet dhe veprimtarinë kolegjiale të këtij organi. Shumat kanë qenë të njëjta në vitet 2021 dhe 2023 (2,480,000 lekë), me një rënie në 2,400,000 lekë në vitin 2022 dhe 1,520,000 lekë në vitin 2024. Sekretariati Teknik i Digave të Mëdha (SKDM), si strukturë ekzekutive e KKDM-së, është mbështetur financiarisht me 3,124,920 lekë në vitin 2021, 3,190,000 lekë në 2022, 2,878,897 lekë në 2023 dhe 3,923,080 lekë në 2024. Komiteti Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) ka marrë fonde të qëndrueshme në tre vitet e para (600,000 lekë) dhe 520,000 lekë në vitin 2024.

Tab. nr. 2, Financimi i strukturave⁸ për sigurinë e digave (në lekë)

Nr.	Institucioni/Viti	2021	2022	2023	2024
1	KKDM	2,480,000	2,400,000	2,480,000	1,520,000

⁸ Të dhënat e kësaj table paraqesin fonde për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore dhe onorare.

2	ITD	0	0	0	228,662
3	SKDM	3,124,920	3,190,000	2,878,897	3,923,080
4	KTPD	600,000	600,000	600,000	520,000
TOTAL		6,204,920	6,190,000	5,958,897	6,191,742

Burimi: MIE

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Për sa i përket Inspektoratit Teknik të Digave (ITD), ky institucion nuk ka funksionuar përpara vitit 2024 dhe për rrjedhojë nuk ka pasur alokime buxhetore në vitet 2021–2023. Vetëm në vitin 2024 janë parashikuar fonde për funksionimin e tij në vlerën 228,662 lekë. Kjo pasqyron fillimin e veprimtarisë së tij në atë vit dhe përfshirjen në sistemin institucional për monitorimin e sigurisë së digave. Totali i fondeve për të katër strukturat në vitet përkatëse është 6,204,920 lekë në 2021, 6,190,000 lekë në 2022, 5,958,897 lekë në 2023 dhe 6,191,742 lekë në 2024. Për anëtarësimin e Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD) janë kryer pagesa të rregullta vjetore në këto vlera: 694,648 lekë në vitin 2021, 661,865 lekë në 2022, 612,028 lekë në 2023 dhe 610,825 lekë në 2024. Këto pagesa lidhen me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë për të ruajtur statusin e saj si anëtare në këtë organizatë.

Tab. nr.3. Pagesa për anëtarësim në ICOLD (në lekë)

Viti	Shuma e pagesës ICOLD
2021	694,648
2022	661,865
2023	612,028
2024	610,825

Burimi: MIE,

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Bashkia Tiranë

Gjatë periudhës 2021 – 2022, Bashkia Tiranë ka ndërmarrë ndërhyrje në infrastrukturën ujore nëpërmjet fondeve të alokuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadër të Programit “Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit”. Konkretisht, nga Drejtoria e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është realizuar projekti “Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik të Rezervuarit Gjyslikonjë”. Vlera e plotë e projektit të akorduar ishte 46,847,000 lekë, ndërsa kontrata e punimeve u lidh në shumën 41,341,218 lekë. Nga kjo kontratë janë realizuar punime në vlerën 41,307,550 lekë.

Tab. nr. 4. Projekti i rehabilitimit të rezervuarit Gjyslikonjë (në lekë)

Nr.	Projekti	Vlera e plotë e Projektit e akorduar	Vlera e plotë e Kontratës së Punimeve	Vlera e Punimeve të realizuara	Viti
1	“Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik të Rezervuarit Gjyslikonjë”	46,847,000	41,341,218	41,307,550	2021 - 2022

Burimi: Bashkia Tiranë,

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Bashkia Berat

Bashkia Berat ka paraqitur informacionin financiar për vitin 2021 në kuadër të këtij auditimit, nga ku ka rezultuar se gjatë vitit 2021 është planifikuar një buxhet prej 960,000 lekësh për mirëmbajtjen e objekteve specifike në zërin “saracineskë”, nga të cilat janë realizuar 780,000 lekë. Kjo shumë është përdorur për tenderimin dhe zbatimin e kontratës me objekt “Blerje dhe vendosje saracineske”.

Tab. nr. 5. Shpenzime për mirëmbajtje për vitin 2021

(në lekë)

		Emri	Plan	Fakt
602	6025400	Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike, Saraçineskë	960,000	780,000

Burimi: Bashkia Berat

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ka ndërmarrë investime për rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë ndërhyrje në diga që janë në administrim të Drejtorive të Ujitjes dhe Kullimit (DUK), si dhe në pronësi apo administrim të bashkive. Në kuadër të programit buxhetor “Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”, investimet për rehabilitimin e digave janë shtrirë në dy faza kryesore kohore: 2019 – 2021 dhe 2024 – 2026. Totali i financimeve të kontraktuara ose planifikuara për këtë periudhë arrin në **906,218,260 lekë**, ndërsa financimi faktik i realizuar është **877,129,464 lekë** (tabela nr. 6). Projekti përfshin rehabilitimin e digave që administrohen nga DUK - të, përmes financimeve nga programi i MBZHR. Këto investime kapin vlerën e **285,752,609 lekëve**, nga të cilat **285,556,709 lekë** janë realizuar faktikisht.

Tab. nr. 6. Investime për rehabilitimin e digave nga MBZHR

(në lekë)

Nr	Emërtimi i projektit	Institucioni përgjegjës	Periudha e financimit	Vlera e financimit Kontraktuar /Plan	Vlera e financimit Fakt
	TOTAL		2019 - 2026	906,218,260	877,129,464
Diga të MBZHR - së					
A	Diga të MBZHR të administruara nga Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit, të financuara me investimet e programit "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes", për objektet në administrim të DUK-ve	DUK-të	2020 - 2026	285,752,609	285,556,709
-	Rehabilitimi i digës së rezervuarit Shkodër, Shkodër	DUK Lezhë	2020 - 2021	28,462,938	28,267,038
-	Rehabilitimi i ushqyesit të rezervuarit të Bllacës dhe rehabilitimi i rezervuarit të Bllacës (burimi ujor)	DUK Durrës	2024 - 2026	257,289,671	257,289,671
Diga të Bashkive					
B	Diga në administrim të bashkive të financuara me fondin e dedikuar për bashkitë ⁹ ,	Bashkitë	2019 - 2021	620,465,651	591,572,755
	Rehabilitimi digës së ujëmbledhësit Tapizë	Krujë		204,444,551	204,044,902
	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Shoshaj	Mat		35,042,798	21,756,552
	Rehabilitim i ujëmbledhësit Kurjan	Roskovec		25,090,855	24,657,594
	Rezervuari Paskuqan	Kamëz		111,327,896	111,327,896
	Rehabilitimi i digës së rezervuarit Kukaj	Pukë		19,069,255	18,846,895
	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Arapaj 1	Durrës		19,945,786	19,396,594
	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Spitallë	Durrës		12,554,160	12,114,862
	Rehabilitimi i digës dhe skemës ujitëse të rezervuarit të Okshtunit	Rrogozhinë		46,000,000	46,000,000

⁹ Sipas VKM nr. 170, datë 27.03.2029 "Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit 1,000,000,000 (një miliard) lekë në programin "Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit", i ndryshuar me VKM nr. 799, datë 11.12.2019, dhe VKM nr. 488, datë 17.06.2020 "Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit prej 950,295,959 lekësh, në programin "Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit", i ndryshuar me VKM nr. 625, datë 29.07.2025.

	Rehabilitimi i Digës së Gramës	Dibër		56,911,841	56,226,732
	Rehabilitimi i digave të ujëmbledhësve të bashkisë Dropull (Kakavijë, Likomil, Peshkëpi dhe Bodrisht) dhe kanalit ujitës i rezervuarit të Peshkëpisë	Dropull		43,231,509	35,893,178
C	Reabilitim i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anësor të rezervuarit Gjyslikonjë.	Tiranë		46,847,000	41,307,550

Burimi: MBZHR

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Po kështu, projekti përfshin edhe fond të dedikuar me VKM¹⁰ për disa bashki të vendit. NJVQV – të janë mbështetur financiarisht përmes këtij fondi për periudhën 2019 – 2021, duke iu alokuar **620,465,651 lekë**, nga të cilat **591,572,755 lekë** janë shpenzuar për projekte në bashkitë Krujë, Mat, Roskovec, Kamëz, Pukë, Durrës, Rogozhinë, Dibër, Dropull dhe Tiranë (sipas tabelës nr. 6 më sipër). Për periudhën 2016 – 2019, me financim të Bankës Botërore nëpërmjet programit buxhetor "Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes" të MBZHR – së janë rehabilituar 11 diga me vlerë investimi të realizuar 1,105,699,976 lekë të shpërndara në bashkitë Has, Patos, Berat, Devoll, Maliq dhe DUK-të e Fierit dhe Korçës (tabela nr. 7).

Tab. nr. 7. Investime për rehabilitimin e digave me financim të Bankës Botërore (në lekë)

Nr.	Emërtimi i Digës	Institucioni përgjegjës	Periudha e financimit	Vlera e financimit Fakt
1	Tregtan 2	Bashkia Has	2016 - 2019	26,095,937
2	Tregtan 3	Bashkia Has	2016 - 2019	31,723,825
3	Vranisht 2	Bashkia Has	2016 - 2019	66,768,293
4	Murritz- Thana	DUK Fier	2016 - 2019	318,107,948
5	Zharrëz	Bashkia Patos	2016 - 2019	89,559,017
6	Kurjan	DUK Fier	2016 - 2019	17,831,400
7	Strum	DUK Fier	2016 - 2019	8,956,760
8	Belesovë	DUK Korçë	2016 - 2019	84,785,894
9	Duhas	Bashkia Berat	2016 - 2019	111,534,734
10	Koshnicë	Bashkia Devoll	2016 - 2019	286,100,047
11	Leminot	Bashkia Maliq	2016 - 2019	64,236,120
	TOTALI	Bashkitë/DUK-të	2016 - 2019	1,105,699,976

Burimi: MBZHR

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Për vitin 2024, përmes Fondit për Digat të akorduar nga programi "Emergjencat Civile" në Ministrinë e Mbrojtjes, është mundësuar financimi i disa projekteve të reja me vlerë **499,894,715 lekë**. Këto ndërhyrje, sipas VKM nr. 306, datë 22.05.2024, përfshijnë 14 projekte në bashkitë Mallakastër, Kuçovë, Vorë, Has, Tropojë, Përmet, Klos, Korçë, Këlcyrë, Finiq, Fushë-Arrëz, Shijak, Belsh dhe Tiranë.

Tab. nr. 8. Investime për rehabilitimin e digave të bashkive, nëpërmjet Fondit për Digat (në lekë)

Nr.	Emërtimi i projektit	Institucioni përgjegjës	Periudha financimit	Vlera e financimit Plan
A	Diga në administrim të bashkive të financuara nëpërmjet Fondit për Diga në programin "Emergjencat Civile", për vitin	Bashkitë	2024	499,894,715

¹⁰ VKM nr. 170, datë 27.03.2029 "Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit 1,000,000,000 (një miliard) lekë në programin "Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit", i ndryshuar me VKM nr. 799, datë 11.12.2019; VKM nr. 488, date 17.06.2020 "Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit prej 950,295,959 lekësh, në programin "Menaxhimi i infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit", i ndryshuar me VKM nr. 625, date 29.07.2025.

	2024, të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes, ¹¹			
	Punime për rehabilitimin e digës së rezervuarit të Gadurovës	Mallakastër		81,159,283
	Rehabilitimi i digës Goraj.	Kuçovë		53,112,034
	Rehabilitim i digës së rezervuarit Gjokaj 1	Vorë		21,345,594
	Rehabilitim me qëllim mbi ngritje e digës së rezervuarit “Helashan 2”	Has		48,595,670
	Rehabilitimi i ujëmbledhësit Zherka 1-2 dhe i ujëmbledhësit degë, NJA Fjerzë.	Tropojë		18,745,977
	Rehabilitimi i rezervuarit Qilarisht	Përmet		29,776,463
	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Bejn 1	Klos		54,228,411
	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit të Gjonomadhit	Korçë		15,532,056
	Rehabilitim i rezervuarit Këlcyrë	Këlcyrë		19,238,874
	Rehabilitim i shkarkuesit katastrofik të digës së rezervuarit Karroq	Finiq		26,837,271
	Rehabilitim i digës së rezervuarit Iballë	Fushë-Arrëz		59,417,849
	Rehabilitimi i rezervuarit të digës Bilalaj	Shijak		5,187,917
	Punime për rehabilitimin dhe rritjen e sigurisë së digës Belsh dhe pastrimin e kanalit të shkarkimit (vaditëse)	Belsh		47,340,330
	Rikonstruksioni i digës së rezervuarit të Farkës	Tiranë		19,376,986

Burimi: MBZHR

Përpunoi: Grupi i Auditimit

2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore

Në fazën e parë studimore institucionet e përfshira në auditim i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë pyetësorëve të dërguar nga grupi i auditimit. Përjashtim bën MIE dhe KKDM të cilat nuk iu përgjigjën shkresës së grupit të auditimit për kërkesë për informacione për digën e Moglicës protokolluar në MIE me nr. 22.9. datë 22.09.2025. Megjithatë ky fakt nuk ndryshon bindjen e grupit të auditimit mbi gjendjen dhe problematikat që ekzistojnë në digën Moglicës për arsye se grupi i auditimit ka kryer një vizitë në këtë digë.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Analiza e riskut në programin e auditimit të performancës “Mbrojtja dhe siguria e digave” është një komponent thelbësor për identifikimin dhe vlerësimin e pengesave që mund të ndikojnë në efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për këtë fushë kritike. Kjo analizë u realizua duke përdorur modelin SWOT, i cili ndihmoi në klasifikimin e faktorëve të brendshëm (forcat dhe dobësitë) dhe të jashtëm (mundësitë dhe kërcënimet) që ndikojnë në funksionimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë së digave. Në këtë kuadër, si fuqi u identifikuan kuadri ligjor dhe rregullator ekzistues, strukturat institucionale të ngritura si KKDM, SKDM, ITD dhe KTPD, si dhe përvoja e mëparshme e auditimeve dhe anëtarësimi në rrjete ndërkombëtare si ICOLD. Megjithatë, dobësitë që paraqesin risk të lartë për performancën janë të shumta si për shembull mungesa e koordinimit ndërinstytucional, kapacitetet teknike të pamjaftueshme në nivel vendor, mungesa e mirëmbajtjes sistematike të digave, mbikëqyrja e fragmentuar dhe mungesa e planeve emergjente apo sistemeve të paralajmërimit. Nga ana tjetër, mundësitë për përmirësim përfshijnë rritjen e financimeve publike për sigurinë e digave, mundësinë për modernizim dhe dixhitalizim të sistemit të monitorimit, përfshirjen e aktorëve të rinj dhe ndërgjegjësimin në rritje institucional mbi këtë çështje. Por, këto mundësi sfidohen nga kërcënime reale si rritja e përmbajtjeve për shkak të ndryshimeve klimatike, mungesa e investimeve të qëndrueshme për rehabilitimin e digave, mungesa e një sistemi të klasifikimit sipas riskut, dhe rreziku i moszbatimit të reformave apo rekomandimeve audituese. Kjo

¹¹ Sipas VKM - së nr. 306, datë 22.05.2024 "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për digat, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore"

analizë e detajuar ndihmon grupin e auditimit të përcaktojë fushat me risk të lartë që kërkojnë vëmendje të menjëhershme, si dhe të orientojë vlerësimin e performancës së institucioneve në drejtim të efektivitetit të masave të marra, nëse janë të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për të garantuar mbrojtjen e jetës njerëzore, mjedisit dhe pronës publike nga rreziqet e dështimit të digave.


Fig.1 Analiza SWOT



3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Mbrojtja dhe siguria e digave” ka si objektiv kryesor të vlerësojë nëse institucionet përgjegjëse kanë marrë masat e duhura me qëllim përmirësimin e gjendjes së digave. Me anë të këtij objektivi do të mund të konkludojmë se deri në çfarë mase ka qenë efektive veprimtaria e institucioneve subjekt auditimi për periudhën 2021-2024.

3.3 Pyetjet e auditimit



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka pasur në fokus të tij veprimtarinë e institucioneve që shfrytëzojnë digat (MBZHR, Bashkitë Tiranë e Berat) si dhe institucioneve të tjerë (MIE si dhe KKDM) që kontrollojnë e monitorojnë shfrytëzuesit e digave. Krahas panoramës së përgjithshme në nivel kombëtar lidhur me kontrollin, monitorimin dhe raportimin sa i përket sigurisë së digave, në këtë auditim jemi fokusuar në mënyrë të veçantë në disa diga specifike si për shembull diga e Liqenit Artificial të Tiranës, diga e Bovillës, diga e Moglicës dhe ndonjë digë tjetër që do të për zgjidhet në vazhdimësi. Disa nga elementët kryesorë të trajtuar në këtë auditim janë si më poshtë:

- Përcaktimi dhe fushëveprimi i qartë e i duhur i kuadrit ligjor të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së digave;
- Identifikimi dhe përditësimi i listës së digave në Shqipëri në respektim të përcaktimit të kuadrit ligjor në fuqi;
- Mbulimi dhe mbikëqyrja me kontrole dhe inspektime nga institucionet përkatëse;
- Vlerësimi i gjendjes teknike të digave dhe klasifikimi i tyre sipas nivelit të riskut që ato përfaqësojnë;
- Masat e marra nga shfrytëzuesit e digave me qëllim përmirësimin dhe rritjen e sigurisë së digave që ato kanë në administrim;
- Monitorimi i digave veçanërisht sa i përket volumeve aktuale të ujit, sedimenteve në rezervuarët e krijuar nga këto diga si dhe funksionimit të portave të shkarkimit;
- Planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile (PGEC) si dhe sistemet e alarmit;
- Hartimi dhe raportimi i shfrytëzuesve të digave në KKDM mbi gjendjen teknike të digave;
- Braktisja e digave etj.

Periudha objekt auditimi ka qenë 2021-2024, megjithatë janë pasqyruar edhe të dhëna historike jashtë kësaj periudhe për të dëshmuar më qartë ecurinë e treguesve të ndryshëm.

4. SHJTËLLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT

Pyetja kryesore: A kanë marrë institucionet përgjegjëse masat e duhura për të vlerësuar dhe përmirësuar gjendjen teknike të digave?

MESAZHI I AUDITIMIT

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkitë Tiranë e Berat si dhe institucionet e tjera shtetërore përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe kontrollin e digave nuk kanë vlerësuar gjendjen e të gjitha digave në vendin tonë dhe nuk kanë marrë masat e duhura për përmirësimin e gjendjes së tyre. Kuadri ligjor e rregullator nuk garanton një mbikëqyrje të plotë për të gjitha digat duke lënë jashtë vëmendjes digat e vogla. Objekt i veprimtarisë së Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM) kanë qenë kryesisht digat e mëdha (rreth 350) ndërkohë që legjislacioni nuk i përjashton digat e vogla (rreth 300) nga fushëveprimi i tij. Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha, Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave dhe Inspektorati Teknik i Digave nëpërmjet veprimtarisë së tyre, nuk kanë garantuar mbulim me kontrole efektive të të gjitha digave në vendin tonë. Kontrolli, monitorimi dhe raportimi mbi gjendjen dhe sigurinë e digave vuan mungesën e ngritjes dhe funksionimit të të gjitha strukturave mbikëqyrëse, sistemeve të monitorimit dhe raportimit jo të plotë e të qartë. Edhe pse janë kryer disa investime rehabilitues në 43 diga të ndryshme, ka munguar vëmendja institucionale dhe investime të qëndrueshme për përmirësimin e sigurisë së digave. Bashkia Tiranë dhe Berat nuk kanë pasur qasje pro aktive në gjurmimin dhe përthithjen e fondeve të ndryshme për të realizuar projekte rehabilituese në digat që kanë në administrim.

4.1 A garanton kuadri ligjor e rregullator një mbikëqyrje të duhur e të plotë lidhur me sigurinë e digave?

4.1.1 A kanë hartuar dhe miratuar institucionet përgjegjëse politika të duhura për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e digave?

Në vendin tonë nuk ka të dhëna të sakta mbi numrin total të digave.

KKDM, në veprimtarinë kontrolluese mbi sigurinë e digave nuk është fokusuar në digat e vogla.

Ligji nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” ka për qëllim të ndërtojë kuadrin bazë ligjor dhe institucional, nga i cili do të rrjedhë i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që rregullon procesin e projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së digave. Në nenin 3 të këtij ligji përcaktohet qartë fushëveprimi i tij në të gjitha digat, (që ndërtohen të reja ose janë në shfrytëzim), të shtrira në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) Lartësia e digës/dambës të jetë mbi 15 metra;
- b) Lartësia e digës të jetë 10 deri 15 metra kur;
 - vëllimi i ujit të grumbulluar është mbi 1 hm³ (një milionë m³) ujë;
 - gjatësia e kurorës është mbi 500 metra;
- c) Çdo digë tjetër, që nuk plotëson kushtet në pikat "a" dhe "b", përbën rrezik për të “tretët”.

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha çdo vit miraton listën e digave (e cila hartohet nga Komiteti Teknik i Përherëshëm i Digave) ku jepen të dhëna për shfrytëzuesit e tyre, lartësinë e tyre, vitin e përfundimit të ndërtimit, vendndodhjen si dhe të dhëna lidhur me rezervuarët ujorë (vëllimi, volumi dhe qëllimi i përdorimit të rezervuarëve) për të cilat këto diga shërbejnë. Deri në qershor 2025 në faqen zyrtare të KKDM-së (Figura 1) ishte i publikuar vetëm regjistri i digave të mëdha¹². Nuk kishte asnjë të dhënë nga KKDM lidhur me digat e vogla¹³. Në datë 28.04.2025 grupi i auditimit ka kërkuar nga KKDM se cilat janë digat e vogla të përcaktuara në përputhje me nenin 3 pika c të ligjit nr. 8681 datë 2.11.2000. Në përgjigjen e tij më datë 29.05.2025¹⁴ referuar kësaj kërkesë, KKDM nuk ka vënë në dispozicion listën e digave të vogla. Megjithatë, grupi i auditimit gjatë rishikimit të faqes zyrtare të KKDM-së në tetor 2025 ka vërejtur se ajo është pasuruar me të dhëna edhe për digat e vogla. Para tetorit të 2025 nuk ka asnjë gjurmë të një regjistri i cili të përmbajë të dhëna edhe për digat e vogla.

Është e rëndësishme të theksohet se Ligji nr. 8681, datë 02.11.2000 për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave i referohet të gjitha digave të klasifikuara në përputhje me nenin 3 të tij. Ndaj, është po kaq e rëndësishme që regjistri i digave të vogla të përcaktohet çdo vit ashtu siç është bërë me regjistrin e digave të mëdha. Vëmendja kryesore e KKDM-së ndër vite ka qenë te digat e mëdha të përcaktuara në përputhje vetëm me nenin 3 pika a dhe b të ligjit për projektimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave. Grupi i auditimit ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha raportet vjetore të Komitetit Kombëtar i Digave të Mëdha për periudhën 2020-2024. Në të gjitha këto raporte fokusi kryesor i KKDM-së është vetëm te digat e mëdha. Sa i përket digave të vogla nuk ka asnjë të dhënë në këto raporte përveç numrit të tyre të përafërt si dhe 2-3 problematikave përgjithësuere ndaj tyre të cilat përsëriten në

¹² Sqarim: Termi digë e madhe i referohet digave sipas përcaktimit të Ligjit nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, neni 3 pika a dhe b.

¹³ Sqarim: Termi digë e vogël i referohet digave sipas përcaktimit të Ligjit nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, neni 3 pika c.

¹⁴ Kthim përgjigje e KKDM-së me shkresën nr. 54/3 datë 29.05.2025, e protokolluar ne KLSH me nr 324/8 prot. datë 05.06.2025.

raportet e çdo viti. Nëse do t'i referohemi të dhënave të KKDM-së, sot në Shqipëri kemi 647 diga (350 diga të mëdha dhe 297 diga të vogla)¹⁵. Ndërkohë nëse do t'i referohemi të dhënave të tjera zyrtare numri i digave të mëdha e të vogla rezulton ndryshe. Kështu, sipas Planit Kombëtar të Emergjencave Civile¹⁶ rezulton se në Shqipëri janë 626 diga. Vet Kryetari i KKDM-së z. A. J. në qershor 2023 në një prononcim mediatik¹⁷ ka përmendur se në Shqipëri janë 652 diga në total. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë rezultojnë të jenë rreth 670 diga. Të gjitha këto burime të ndryshme të cilat referojnë shifra të ndryshme sa i përket numrit total të digave, ngrenë pikëpyetje të madhe mbi numrin e saktë të digave në vendin tonë.

Fig 2. Rubrika me të dhëna për digat e mëdha



Hyrje Rreth Nesh Legjislacioni **Digat dhe Dambat ne Shqiperi** Foto Galeri Veprimtaria e KKDM Inxhinieret e Rinj te Digave

Regjistri Kombëtar i Digave të Mëdha në Shqipëri 2024.

4 Qershor, 2021

Për të parë Regjistrin Kombëtar të DM 2024 sipas shfrytëzuesve të tyre, klikoni [këtu](#)

Për të parë Regjistrin Kombëtar të DM 2024 sipas lartësisë (H) të tyre, klikoni [këtu](#)

Për të parë Regjistrin Kombëtar të DM 2024 sipas vitit të perfundimit të ndërtimit të tyre, klikoni [këtu](#)

Për të parë vendodhjen e DM 2024 në territorin e Republikës së Shqipërisë, klikoni [këtu](#)

Burimi: KKDM

Numri i digave të vogla nuk përputhet midis të dhënave të Bashkisë Tiranë dhe Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha.

Grupi i auditimit ka kërkuar të dhëna mbi digat nga subjektet nën auditim dhe konkretisht Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha, Bashkisë Tiranë e Berat si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë e cila disponon dhe ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit të gjithë *data-base* e trashëguar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për të gjitha digat në Shqipëri. Pavarësisht se *data-base* e MIE-s është përgatitur nga MBZHR në vitin 2015, ajo ka shërbyer për kryqëzimin e informacioneve por dhe për identifikimin e problematikave që digat mund të kenë. Krahas informacioneve mbi karakteristikat e digave (viti i prodhimit, lartësia, vendndodhja etj.) ajo pasqyron të dhëna lidhur me gjendjen e trupit të digës, gjendjen e shkarkuesit katastrofik, gjendjen e ujëlëshuesit, vëllimin e ujit të projektuar/fakt të rezervuarit. Formatit dhe struktura e kësaj *data-base* është më e plotë se të dhënat që KKDM zotëron për digat në Shqipëri. Megjithatë, kjo *data-base* siç thamë edhe më sipër është përgatitur në vitin 2015 dhe që prej asaj periudhe nuk është përditësuar më. Krahas këtyre të dhënave grupi i auditimit kërkoi të dhëna edhe nga Bashkia Tiranë për të gjitha digat që ajo administron. Nga kryqëzimi i informacioneve të Bashkisë Tiranë dhe Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha rezulton një mos përputhje e numrit të digave që janë në shfrytëzim të Bashkisë Tiranë. Nga të dhënat e përfuara nga Bashkia Tiranë rezultojnë 38 diga të mëdha dhe 8 diga të vogla që shfrytëzohen nga ky institucion¹⁸. Ndërkohë, nga të dhënat e përfuara nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha rezulton që

¹⁵ KKDM, Regjistri i digave të mëdha dhe regjistri i digave të vogla.

¹⁶ <https://akmc.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Plani-Kombetar-per-Emergjencat-Civile.pdf> fq 183

¹⁷ <https://dritare.net/ngjarjet-e-dites/sa-diga-ka-shqiperia-flet-kryetari-i-komitetit-te-digave-arjan--i744486>

¹⁸ Bashkia Tiranë

Bashkia Tiranë administron 38 diga të mëdha dhe 21 diga të vogla¹⁹. Pra kemi të bëjmë me një mos përputhje të numrit të digave të vogla midis dy institucioneve që kanë përgjegjësi lidhur me shfrytëzimin e digave (Bashkia Tiranë) dhe monitorimin dhe mbikëqyrjen e tyre (KKDM). Kjo mos përputhje dëshmon edhe një herë mos fokusimin nga ana e KKDM-së në digat e vogla.

Tab. nr.8 Lista e digave të mëdha të Bashkisë Tiranë

Nr	Emërtimi i digës	Nr	Emërtimi i digës
1	PUREZ	20	BESH
2	PEZË GJYSLIKANE	21	RINË
3	PEZË HELMËS	22	ÇEKREZË
4	FJOLLË	23	ZALL-HERR 1
5	PËRROI I ARAVE	24	ZALL-HERR 2
6	BOZANXHIAS	25	TAPIZË 2
7	PINET 1	26	FARKË
8	PINET 2	27	XINGERE
9	MUSTAFA KOÇ	28	KASHAR
10	VESKIE	29	SHARRË
11	ZELAJ	30	ALLGJATË
12	GURRË	31	ROVË
13	STËRMAS	32	ALLTATË
14	SKORANË	33	BALHAXHIAS
15	TUFINË	34	SHTËPAZË
16	BIZË	35	LANABREGAS
17	FAÇESH	36	KOLLOGJESH
18	SHUPAL KODËR	37	VRAP
19	KUTREQ	38	SHUPAL

Burimi: Bashkia Tiranë

Tab. Nr. 9 Lista e Digave të Vogla, Bashkia Tiranë

Nr	Emërtimi i digës
1	PRUSH
2	PARET
3	FORTUZAJ
4	ZARANIKA 1
5	ZARANIKA 2
6	LINZË
7	SHUPAL
8	SAUK

Burimi: Bashkia Tiranë

Legjislacioni shqiptar nuk ka parashikuar vlerësimin dhe klasifikimin e digave sipas nivelit të riskut që ato përfaqësojnë.

Vende të ndryshme përdorin sisteme të ndryshme klasifikimi për digat në lidhje me vlerësimin e rreziqeve të sigurisë që lidhen me to. Këto klasifikime shërbejnë për qëllime projektimi, licencimi, ose mund të përdoren për qëllime të tjera, të tilla si kontrolli, inspektimi dhe planifikimi i buxhetit.²⁰ Shumica e këtyre sistemeve miratojnë kritere bazuar në parametra të digës të tilla si lartësia ose madhësia e rezervuarëve dhe/ose rreziqet e mundshme që shkaktojnë humbje jete dhe humbje ekonomike.

¹⁹ <https://albcold.gov.al/wp-content/uploads/2025/06/Regjistri-i-Digave-te-Vogla-per-vitin-2025.pdf>

²⁰ https://www.researchgate.net/publication/343219520_Dam_Safety_and_Dams_Hazards fq 3

Klasifikimi i digave nga Agjencia Federale e Menxhimit të Emergjencave - Federal Emergency Management Agency (FEMA)

Kjo agjenci u krijua në SHBA në prill të vitit 1979 me objektivin e mbrojtjes së njerëzve nga rreziqet që lidhen me termocentralet bërthamore, transportin e substancave të rrezikshme, si dhe mbrojtjen ndaj rreziqeve që lidhen me fatkeqësitë natyrore. Rritja e sigurisë publike që shkaktohet nga digat u bë gjithashtu një nga shqetësimet dhe prioritetet e saj kryesore. Klasifikimi i digave të miratuara dhe të përdorura nga FEMA ndjek dy kritere:

- Humbjet e jetës;
- Humbjet ekonomike, mjedisore dhe shërbimeve në infrastrukturë.

Përdoren tre nivele klasifikimi, të cilat janë: i ulët, i rëndësishëm dhe i lartë, të renditura sipas pasojave negative në rritje.

Tab. nr. 10 Klasifikimi i digave sipas rrezikut të tyre potencial

Klasifikimi	Humbjet e jetës	Dëme ekonomike, mjedisore dhe shërbimeve në infrastrukturë
A – i ulët	Jo e pritshme	I ulët dhe përgjithësisht i kufizuar të shfrytëzuesi
B – mesatar	Jo e pritshme	Po
C – i lartë	E pritshme	Po

Burimi: Dam Safety and Dams Hazards,

A. Potencial i rrezikut të ulët

Digat e klasifikuara si potencial i ulët rreziku janë ato ku dështimi ose keqfunksionimi i tyre nuk rezulton në humbje të mundshme të jetës njerëzore dhe dëme ekonomike dhe/ose mjedisore; por dëmet janë kryesisht të kufizuara vetëm në prona në afërsi të tyre.

B. Potencial i rrezikut mesatar

Digat e klasifikuara si potencial i rëndësishëm rreziku janë ato diga ku dështimi ose keqfunksionimi i tyre nuk rezulton në humbje të mundshme të jetës njerëzore, por mund të shkaktojë dëme ekonomike, mjedisore, dëmtime në infrastrukturë etj. Digat e klasifikuara si potencial i rëndësishëm rreziku shpesh ndodhen në zona kryesisht rurale ose bujqësore, por mund të vendosen në zona me popullsi dhe infrastrukturë të rëndësishme.

C. Potencial i rrezikut të lartë

Digat e klasifikuara si me rrezik të lartë potencial janë ato ku dështimi ose keqfunksionimi i tyre ka të ngjarë të shkaktojë humbje të jetës njerëzore, përveç dëmeve ekonomike, dhe/ose mjedisore. Ky klasifikim parashtron se dështimi ose keqfunksionimi i çdo dige, sado i vogël të jetë, përfaqëson një rrezik potencial për jetën dhe pronën në rrjedhën e poshtme. Sa herë që ka një lëshim të pakontrolluar të ujit, ekziston mundësia, pavarësisht se sa e papritur është, që dikush/diçka të ndodhet në rrugën e shkarkimit. Dallimi midis niveleve të klasifikimit të potencialit të rrezikut mesatar dhe të lartë është kriteri i humbjes së jetës; ku një digë me rrezik të lartë mund të shkaktojë humbje të mundshme të jetës njerëzore ndërsa në një digë me rrezik mesatar një humbje e tillë nuk pritet.

Në një numër të madh vendesh (SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Australia etj.) klasifikimi i sigurisë së digave dhe masat e kërkuara për mbrojtjen e sigurisë publike përcaktohen nga legjislacioni në formën e ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve. Vende të tjera, (si për shembull Iraku), nuk kanë një sistem klasifikimi mbi rrezikun që digat

përfaqësojnë, pavarësisht digave të shumta që zotërojnë dhe faktit se ato kërcënojnë sigurinë e miliona njerëzve. Në të njëjtën situatë është edhe Shqipëria. Prandaj, është koha që qeveritë përkatëse të këtyre vendeve t'i kushtojnë vëmendje kësaj çështjeje të rëndësishme duke parashikuar në legjislacion klasifikimin e rrezikshmërisë së digave²¹.

Zyra e Kontrollit të Përgjithshëm të shtetit New York-ut në një auditim²² të vitit 2006 mbi sigurinë e digave ka trajtuar disa aspekte lidhur me klasifikimin e digave sipas nivelit të riskut që ato përfaqësojnë. Objektivi i këtij auditimi ishte të vlerësohej nëse Seksioni i Sigurisë së Digave i Departamentit të Ruajtjes së Mjedisit kishte ndërmarrë veprime në kohë për të korrigjuar kushtet në diga të identifikuara me mangësi. Bazuar në kuadrin ligjor e rregullator, Departamenti i Ruajtjes dhe Mjedisit kishte klasifikuar digat sa i përket nivelit të riskut që ato përfaqësojnë siç tregohet në tabelën më poshtë. Departamenti mund të ndryshojë klasifikimin e rrezikut të një dige, pasi gjendja e saj ndryshon me kalimin e kohës si për mirë (kur bëhet fjalë për riparime apo rikonstruksione, ashtu edhe për keq kur bëhet fjalë për amortizim apo edhe fatkeqësi të ndryshme).

Tab. nr. 11 Baza e të dhënave të sigurisë së digave kodit (nivelit/klasifikimit) të rrezikut, 2006

Klasifikimi i rrezikut	Kodi i rrezikut	Numri i digave	Përqindja e digave
I lartë	C	385	5.7
Mesatar	B	757	11.1
I ulët	A	3,895	57.3
Pa rrezik ²³	D	1,217	17.9
Pa vlerësuar		547	8
Total		6,801	100

Burimi: Raport auditimi i Zyrës së Auditimit të New York-ut²⁴

Në Shqipëri nuk ka përcaktime ligjore/nënligjore mbi distancën e sigurisë së digave.

Në kuadrin ligjor e rregullator shqiptar nuk ka përkufizime apo edhe koncepte që lidhen me distancën që objekte të ndryshme duhet të respektojnë nga digat. Shtete të ndryshme mund të vendosin në kuadrin e tyre rregullator distanca sigurie nga digat që ndryshe njihen edhe si zona buferike për të mbrojtur objekte të ndryshme nga pasojat që mund të vijnë nga aksidente apo avari të ndryshme në infrastrukturën e digave.


²¹ Dam Safety and Dams Hazards, Nasrat Adamo, Nadhir Al-Ansari, Varoujan Sissakian, Jan Laue & Sven Knutsson https://www.researchgate.net/publication/343219520_Dam_Safety_and_Dams_Hazards_fq.8.

²² Report 2006-S-61, Selected aspects of the dam safety program, Office of the New York State Comptroller <https://web.osc.state.ny.us/audits/allaudits/093008/06s61.pdf>

²³ Sqarim: Të ka klasifikuara për arsye të mos përfundimit të ndërtimit ose arsye madhësie.

²⁴ <https://web.osc.state.ny.us/audits/allaudits/093008/06s61.pdf>

Fig. 3 Paraqitje skematike e pasojave që lidhen me dëmtimin e digave



Siguria e digës synon të garantojë ujin dhe shërbimet për të cilat është ndërtuar diga, si dhe të mbrojë dhe sigurojë qëndrueshmërinë e komuniteteve, asetëve dhe infrastrukturës në rrjedhën e poshtme. Në fushën e sigurisë së digave, rreziku përcaktohet nga gjasat e një ngjarjeje dhe pasojat që lidhen me të. Rreziqet që lidhen me sigurinë e digave janë specifike për projektimin dhe situatën. Këto ndryshojnë në varësi të komponentëve strukturorë, faktorëve socio-ekonomikë dhe mjedisit brenda të cilit ndërtohet dhe funksionon diga.²⁵

Një studim i Bankës Botërore i cili i referohet Komitetit Kombëtar të Australisë së Digave të Mëdha (ANCOLD) ofron udhëzime të përgjithshme mbi distancën e rekomanduar që duhet pasur në konsideratë në raste të përmytjeve (si rezultat i çarjes së digës) e cila korrespondon me kapacitetin e ruajtjes së rezervuarit.

Tab. nr. 12 Distanca totale deri në rrjedhën e përmytjes së digës

Volumi i rezervuarit	Distanca totale në rrjedhën e poshtme deri te përmytja e shembjes së digës
> 2 milionë m ³	60 km ose më shumë
0.2 – 2 milionë m ³	20 km ose më shumë
< 0.2 milionë m ³	5 km ose më shumë

Burimi: Banka Botërore, *Good Practice Note on Dam Safety*, 2020.

Buletini 157 i ICOLD (2016) ofron gjithashtu udhëzime praktike për digat me lartësi më të vogël se 15 metra për të vlerësuar distancën nga diga ku niveli i përmytjes në rast të çarjes së digës është më i ulët se 0.5 metra.²⁶

Tab. nr. 13 Distanca totale deri në rrjedhën e përmytjes së digës

Lartësia e digës (m)	Distanca nga diga (km)
5	4.7
10	7.0
15	7.0

Burimi: Banka Botërore, *Good Practice Note on Dam Safety*, 2020.

²⁵ <https://www.worldbank.org/en/topic/watersupply/publication/good-practice-note-on-dam-safety-new-guidance-on-managing-risks-associated-with-dams> Chapter 2, page 3.

²⁶ <https://www.worldbank.org/en/topic/watersupply/publication/good-practice-note-on-dam-safety-new-guidance-on-managing-risks-associated-with-dams> Chapter 4, page 55.

Një tjetër element që lidhet me distancën e sigurisë është edhe “*setback distance*” e cila ka si synim të sigurojë një zonë të aksesueshme nga diga në rast të një incidenti ose emergjence në sigurinë e digës, me qëllim mirëmbajtjen e vazhdueshme të saj duke realizuar punime për përmirësimin e gjendjes. Një incident i ndodhur në një digë në vitin 2020 (në Australi) afër së cilës ishte ndërtuar një kompleks banimi deri në majë të argjinaturës së digës, nxori në pah vështirësitë për ndërhyrjet e emergjencës dhe punimet e rehabilitimit.²⁷ “*Setback distance*”, duhet të lejojë:

- Qasje në mënyrë që operacionet e menaxhimit të sigurisë së digës të mund të ndërmerren në mënyrë efektive (p.sh., inspektime dhe mbikëqyrje);
- Qasje në mënyrë që menaxhimi i emergjencave të mund të zbatohet në mënyrë efektive.
- Hapësirë për punimet e përmirësimit të sigurisë së digës që do të ndërmerren në digë për të përmbushur kërkesat rregullatore.

Lidhur me nevojën për përmirësim dhe rishikim të kuadrit ligjor, është shprehur edhe vet KKDM në Vendimin nr. 9, datë 30.03.2022 “Për rishikimin e legjislacionit në fushën e projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit, monitorimit dhe sigurisë së digave”. Në këtë vendim, KKDM thekson se nevojitet qartësimi dhe forcimi i aspekteve ligjore që lidhen me sigurinë e digave ekzistuese dhe zonat poshtë tyre. Ndër të tjera, KKDM argumenton se ndryshmet ligjore që janë bërë në vitet e fundit lidhur me emergjencat civile dhe menaxhimin e integruar të burimeve ujore duhet të reflektohen në kuadrin ligjor për sigurinë e digave.

Pasaporta e digave është krijuar vetëm për 179 diga të mëdha.

Shfrytëzuesit e digave duhet të plotësojnë dosjen e digës që kanë në shfrytëzim. Ajo duhet të hartohet sipas kërkesave të Udhëzimit të Përgjithshëm të KKDM-së mbi dosjen e digave/pasaporta e digave dhe duhet të përmbajë:

- Të dhënat Teknike në lidhje me elementet e papershkueshmerise
- Të dhënat në lidhje me Ujëmbledhësin e Krijuar nga Ndërtimi i Digës (vëllimi i përpunimit, vëllimi i shfrytëzimit dhe vëllimi i vdekur) si dhe Masivet rrëshqitëse (ne se ka) në brigjet që e rrethojnë atë;
- Vizatimet Teknike të Trupit të Digës dhe Sistemeve të Shkarkimit, Devijimit, Marrjes së Ujit dhe Zbrazjes (të pakten Planimetria dhe Prerjet Terthore e gjatesore të tyre)
- Fotografitë të Situata aktuale të Digës dhe elementeve të saj
- Studimet dhe Raportet Mbeshtetese
 - Studimi dhe Raporti Gjeologjik, Gjeoteknik, Gjeologo –Inxhinierik
 - Studimi Sizmik
 - Studimi Hidrologjik
 - Studimi mbi Materialet e Ndërtimit
 - Raporti Hidraulik duke përfshirë edhe rezultatet e llogaritjeve përkatëse
 - Raporti për Instrumentet e kontrollit dhe të matjeve si dhe Sistemet e Monitorimit
 - Çdo dokument teknik i nevojshëm i kërkuar nga KKDM në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Nr. 4, Dt. 18.07.2003 “Për kërkesat e dokumentacionit ligjor dhe teknik që duhet të përmbajë dosja e Digave dhe e dambave”

Elementët e përshkruar më sipër janë vetëm disa prej treguesve kryesorë që pasaporta e digave duhet të ketë. Pasaporta e digave duhet të plotësohet si për digat ekzistuese ashtu edhe për digat që ndërtohen të reja. Grupi i auditimit kërkoi pranë Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të dhëna mbi shfrytëzuesit

27 The State of Victoria Department of Environment, Land, Water and Planning, Guidance Note on Setbacks near Dams, 2022, fq 5.

e të gjitha digave në Shqipëri që kanë hartuar pasaportën e digave. Nga përgjigjet zyrtare të MIE-s është konfirmuar se vetëm 179 nga 350 shfrytëzues të digave të mëdha kanë hartuar pasaportat e digave. Nga auditimi ka rezultuar se Bashkia Berat, nuk ka hartuar pasaportën e digave për asnjë prej 8 digave të mëdha që ajo shfrytëzon. Bashkia Tiranë ka hartuar pasaportën e digave për 27 nga 38 diga të mëdha që ka në shfrytëzim. Megjithatë, siç pohon edhe vet Bashkia Tiranë në përgjigjen e saj zyrtare, rezulton se këto pasaporta kanë mangësi të mëdha sa i përket studimit gjeologjik, gjeoteknik, hidrologjik, hidrogeologjik, sizmik, vizatimet teknike të prerjeve gjatësore dhe tërthore të digës. Ndërkohë, nga ana e KKDM-së në rang vendi nuk ka asnjë informacion për shfrytëzuesit e digave të vogla nëse janë të pajisur me pasaportën e digave.

Planet e gatishmërisë në rastet e emergjencave civile janë hartuar vetëm nga 47 shfrytëzues të digave të mëdha.

Bazuar në Udhëzimin e Përgjithshëm të KKDM-së nr. 32/1 datë 16.11.2020 shfrytëzuesit e digave duhet të përgatisin Planet e Gatishmërisë në rastet e emergjencave civile. Planet e Gatishmërisë duhet të përmbajnë:

- Dosjen teknike/Pasaportën e Digave sipas Vendimit nr. 2 datë 21.09.2020 të KKDM-së;
- Karakteristikat e valës që krijohet në luginën poshtë digës në rastin kur shkarkohet prurja maksimale ose bëhet shkarkim i sforcuar (prurje plus zbraze e detyruar e ujëmbledhësit) ose ndodh prishja e digës;
- Hartat e Përmbytjeve ku të jepen sipërfaqet dhe zonat e përmbytura për secilin prej 4 skenarëve të mundshëm;
- Të dhënat e përgjithshme të sistemit të alarmit të instaluar në zonë duke përfshirë edhe të dhënat për sistemet dhe pajisjet e instaluarat si dhe skemën e sinjalizimi dhe komunikimit në rastet e ndodhjes së ngjarjeve që mund të ndodhin;
- Planin e alarmit, të evakuimit dhe të ndihmës për përballimin e pasojave që vijnë si rezultat i situatave të përshkruara në skenarët përkatës;
- Të dhëna për planin e rrugëve hyrëse në objektet dhe nënobjektet e digës;
- Burimet e furnizimit me energji elektrike në raste defektesh dhe ngjarjesh të veçanta.

Grupi i auditimit nga të dhënat e vëna në dispozicion nga subjektet nën auditim ka evidentuar se vetëm 47 shfrytëzues të digave të mëdha kanë hartuar “Planet e gatishmërisë në rastet e emergjencave civile”. Sa i përket shfrytëzuesve të digave të vogla nuk ka asnjë të dhënë nga subjektet nën auditim (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha) nëse digat e vogla janë pajisur me këto plane apo jo.

1. Gjetje nga auditimi: Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) ushtron veprimtarinë kontrolluese mbi sigurinë e të gjitha digave (të mëdha e të vogla). Për këtë qëllim, ai duhet të hartojë regjistrin kombëtar të digave, i cili duhet të përmbajë të dhëna si për digat e mëdha ashtu edhe për ato të vogla. KKDM, në veprimtarinë e tij për periudhën objekt auditimi, nuk ka pasur në fokusin e vet digat e vogla. Pavarësisht se KKDM ka publikuar regjistrin e digave të vogla në tetor 2025, raportet vjetore të KKDM – së nuk kanë të dhëna specifike mbi sigurinë e digave të vogla, si dhe mungesa e evidencave mbi kontrole të ushtruara në diga të vogla konfirmojnë orientimin e KKDM – së vetëm drejt digave të mëdha. Për më tepër, gjatë auditimit është evidentuar edhe mospërputhje të numrit të digave të vogla në shfrytëzim të Bashkisë Tiranë me të dhënat e KKDM – së. Më konkretisht, sipas Bashkisë Tiranë, ajo ka në shfrytëzim 8 diga të vogla, ndërkohë që sipas KKDM – së janë 21 diga të vogla në shfrytëzim nga Bashkia Tiranë. Mungesa e mbikëqyrjes drejt digave të vogla nga KKDM nuk jep garanci mbi gjendjen e tyre, sa i përket sigurisë që këto diga duhet të garantojnë.

2. Gjetje nga auditimi: Në legjislacionin e vendeve të ndryshme (SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Australia etj.) parashikohet klasifikimi për digat në lidhje me vlerësimin e rreziqeve të sigurisë që lidhen me to. Ndërsa, në legjislacionin e vendit tonë nuk parashikohet/përcaktohet një sistem klasifikimi mbi rrezikun që digat përfaqësojnë, pavarësisht digave të shumta që ne kemi. Mungesa e klasifikimit të rrezikshmërisë së digave, cenon proceset e kontrollit, inspektimit dhe planifikimit të buxhetit për ndërhyrje përmirësuese apo mirëmbajtje të tyre.

3. Gjetje nga auditimi: Në një studim të Bankës Botërore i cili i referohet Komitetit Kombëtar të Australisë së Digave të Mëdha (ANCOLD) sugjerohen udhëzime mbi distancën e rekomanduar që duhet pasur në konsideratë në raste të fatkeqësive (si rezultat i çarjes së digës) e cila korrespondon me kapacitetin e ruajtjes së rezervuarit. Sipas këtij studimi i takon shteteve përkatëse të vendosin në kuadrin e tyre rregullator distanca sigurie nga digat që ndryshe njihen si:

- *zona buferike* për të mbrojtur objekte të ndryshme nga pasojat që mund të vijnë nga aksidente në diga;
- “*setback distance*” e cila ka si synim të sigurojë një zonë të aksesueshme nga diga me qëllim riparimin e avarive apo edhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të saj.

Distancat midis objekteve dhe digave mund të vendosen në varësi të karakteristikave të tyre. Vendi ynë nuk ka parashikuar në kuadrin ligjor e rregullator distanca të sigurisë midis digave dhe objekteve të ndryshme. Mos parashikimi dhe mos vendosja e këtyre distancave nuk garanton mbrojtjen dhe sigurinë e komuniteteve, aseteve dhe infrastrukturës.

4. Gjetje nga auditimi: Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave për pasaportën e digave, përcaktohet se shfrytëzuesit e digave duhet të plotësojnë pasaportën e digës që kanë në shfrytëzim (qofshin ato ekzistuese apo të reja), e cila duhet të përmbajë dokumentacionin ligjor dhe teknik të digës së bashku me karakteristikat kryesore të digës ekzistuese dhe ato të rezervuarit. Nga të dhënat zyrtare të përfuara gjatë këtij auditimi, ka rezultuar se për 179 nga 350 diga të mëdha janë hartuar pasaportat e digave. Ndërkohë, nga ana e KKDM-së nuk ka asnjë informacion për shfrytëzuesit e digave të vogla nëse ata kanë hartuar pasaportën e digave. Nga ana tjetër, Bashkia Berat, nuk ka hartuar pasaportën e digave për asnjë prej 8 digave të mëdha që ajo shfrytëzon. Bashkia Tiranë ka hartuar pasaportën e digave për 27 nga 38 diga që ka në shfrytëzim. Megjithatë, rezulton se këto pasaporta kanë mangësi të mëdha sa i përket studimit gjeologjik, gjeoteknik, hidrologjik, hidrogeologjik, sizmik, vizatimet teknike të prerjeve gjatësore dhe tërthore të digës. Mungesa e pasaportës së digave cenon procesin e mbikëqyrjes dhe mirëmbajtjes së tyre.

5. Gjetje nga auditimi: Referuar udhëzimit të KKDM - së shfrytëzuesit e digave duhet të përgatisin Planet e Gatishmërisë në rastet e emergjencave civile, të cilat duhet të përmbajnë, pasaportën e digave, karakteristikat e valës që krijohet në luginën poshtë digës, hartat e përmbajtjeve, sistemin e alarmit, si dhe planin e alarmit, të evakuimit dhe të ndihmës për përballimin e pasojave në rast fatkeqësie. Nga auditimi ka rezultuar se vetëm për 47 diga të mëdha nga 350 në total shfrytëzuesit kanë hartuar “Planet e gatishmërisë në rastet e emergjencave civile”. Sa i përket shfrytëzuesve të digave të vogla nuk ka asnjë të dhënë nga subjektet nën auditim (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha) nëse digat e vogla janë pajisur me këto plane apo jo. Nga ana tjetër, Bashkia Berat, nuk ka hartuar Planet e Gatishmërisë në rastet e emergjencave civile për asnjë prej 8 digave të mëdha që ajo shfrytëzon. Bashkia Tiranë, ka hartuar Planin e Gatishmërisë në rastet e emergjencave civile vetëm për 1 digë (diga e Farkës) nga 38 diga të mëdha që ka në shfrytëzim. Mungesa e këtyre planeve përbën një cënim të rëndësishëm të sigurisë dhe pasojave ekonomike, mjedisore dhe sociale.

Konkluzion 1: Në Shqipëri mungon një sistem i plotë dhe i unifikuar për menaxhimin e sigurisë së digave. Nuk ka të dhëna të sakta mbi numrin total të digave, mungon klasifikimi sipas nivelit të riskut dhe përcaktimi i distancave të sigurisë. Vetëm një pjesë e vogël e digave të mëdha janë të pajisura me pasaportë dhe plane gatishmërie, çka tregon për dobësi të theksuara në mbikëqyrje, planifikim dhe siguri.

1.1 Rekomandimi: Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, krahas përditësimit të regjistrit të digave (të mëdha e të vogla), të ushtrojë mbikëqyrje dhe kontroll edhe në digat e vogla, si dhe të saktësojë numrin e digave të vogla që Bashkia Tiranë ka në shfrytëzim.

Menjëherë dhe në vijimësi

2 – 3.1 Rekomandimi: Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të propozojnë ndryshime ligjore/nënligjore me qëllim klasifikimin e digave sipas nivelit të riskut që ato paraqesin, si dhe parashikimin e distancave të sigurisë midis digave dhe objekteve të ndryshme.

Brenda datës 30.06.2026

4.1 Rekomandimi: Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha së bashku me Inspektoratin Teknik të Digave të sigurojnë që shfrytëzuesit e të gjitha digave (të mëdha e të vogla) të hartojnë pasaportën e digave. Në këtë kuadër, të dy institucionet të evidentojnë numrin e digave të vogla të pa pajisura me pasaportën e digave.

Brenda datës 30.06.2026

4.2 Rekomandimi: Bashkia Berat të marrë masa që të hartojë pasaportën e digave për të gjitha digat që ka në shfrytëzim.

Brenda datës 30.06.2026

4.3 Rekomandimi: Bashkia Tiranë të hartojë pasaportën e digave për digat të cilat nuk e kanë dhe të plotësojë pasaportat ekzistuese me të gjitha komponentët që ato duhet të kenë në përputhje me udhëzimet e Komitetit Kombëtar i Digave të Mëdha.

Brenda datës 30.06.2026

5.1 Rekomandimi: Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha së bashku me Inspektoratin Teknik të Digave të sigurojnë që shfrytëzuesit e të gjitha digave (të mëdha e të vogla) të hartojnë Planet e Gatishmërisë në rastet e emergjencave civile. Për këtë arsye, të dy institucionet të evidentojnë numrin e digave të vogla të pa pajisura me “Planet e Gatishmërisë në rastet e emergjencave civile”.

Brenda datës 30.06.2026

5.2 Rekomandimi: Bashkitë Tiranë dhe Berat të marrin masa që të hartojnë “Planet e Gatishmërisë në rastet e emergjencave civile” për të gjitha digat që kanë në shfrytëzim.

Brenda datës 30.09.2026

4.1.2 A garanton struktura organizative aktuale mbikëqyrje të duhur mbi sigurinë e digave?

Ligji për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e digave²⁸ miratuar në vitin 2000, identifikon dhe përshkruan kompetencat e organeve shtetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e digave.

Bazuar në këtë ligj funksionojnë:

²⁸ Ligji nr. 8681, datë 2.11.2000 “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”.

- Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha²⁹ (ose KKDM), si një organ i Këshillit të Ministrave i një rëndësie të veçantë në fushën e sigurisë së digave;
- Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave të Mëdha;
- Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha;
- Inspektorati Teknik i Digave.

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha është mekanizmi qendror i kontrollit teknik dhe sigurimit të cilësisë së digave në Shqipëri. Përmes funksioneve të tij të kontrollit, verifikimit dhe miratimit të projekteve, KKDM duhet të garantojë që çdo digë të ndërtohet, të shfrytëzohet dhe të mirëmbahet në kushte të sigurta, duke mbrojtur jetën e qytetarëve, mjedisin dhe interesat ekonomike të vendit. Në këtë drejtim, roli i KKDM - së është thelbësor për të garantuar që ndërtimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e këtyre veprave të rëndësishme hidroteknike të zhvillohet në përputhje me standardet më të larta të sigurisë dhe cilësisë inxhinierike.

Për realizimin e detyrave të tij, KKDM ndihmohet nga Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave si organ këshillimor i tij, në raste kur KKDM duhet të trajtojë çështje me karakter teknik, si për shembull miratimi i projekteve, studime, udhëzues, rregullore teknike etj.

Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (ose SKDM) funksionon si zyrë ekzekutive e KKDM-së. SKDM është pjesë e organikës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Ky Sekretariat ka të drejtë të ushtrojë kontroll në institucionet, që administrojnë digat, si dhe të përgatisë propozime të akteve ligjore dhe nënligjore në këtë fushë. SKDM ka edhe funksion mbështetës dhe teknik në realizimin e detyrave të KKDM-së. Ai siguron përgatitjen, koordinimin dhe zbatimin praktik të vendimeve dhe veprimtarive të Komitetit.

Inspektorati Teknik i Digave (ITD) është organ që ushtron kontroll gjatë ndërtimit, shfrytëzimit e mirëmbajtjes së digave. Inspektorati Teknik i Digave është pjesë e strukturës së SKDM dhe rrjedhimisht e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Organizimi i strukturave nuk ka garantuar mbikëqyrje dhe mbulim me kontroll për të gjitha digat në vendin tonë.

Kontrolli mbi sigurinë e digave në vendin tonë është konceptuar të garantohet nëpërmjet një organizmi qendror siç është Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, që funksionon si një organ i Këshillit të Ministrave, selia e të cilit gjendet pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Buxheti i nevojshëm për të funksionuar i alokohet KKDM – së nëpërmjet MIE. Ky është një model i centralizuar i kontrollit mbi sigurinë e digave, i cili është kushtëzuar përgjatë gjithë kohës së funksionimit të tij nga kapacitete të kufizuara. Kjo situatë nuk i ka lejuar KKDM – së akses të mjaftueshëm në territor dhe mbulim të duhur me kontroll të digave në Shqipëri. Numri i lartë i digave në Shqipëri, mosha e tyre, vendndodhja dhe shtrirja e tyre në gjithë territorin e Shqipërisë, kërkojnë forcimin të kapaciteteve, duke rritur nivelin e mbikëqyrjes së digave.

Në këtë drejtim vlen të theksohet se në varësi të karakteristikave organizative, shtete të ndryshëm anëtarë të ICOLD – it kanë përzgjedhur modele të ndryshme institucionale për të ushtruar kontrollin mbi sigurinë e digave. Sikurse mund të vërehet edhe nga tabela përmbledhëse më poshtë, në përgjithësi shtetet si SHBA – të, Australia dhe Zvicra, të cilët kanë respektivisht modele federale (SHBA dhe Australia) dhe model të decentralizuar (Zvicra), në përgjithësi kanë një autoritet qendror shtetëror dhe përgjegjësi të deleguara për shtetet dhe kantonet të cilat duhet të mbikëqyrin gjithashtu sigurinë e digave.

²⁹ Neni 4, Ligji nr. 8681, datë 2.11.2000 “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”.

Franca nga ana tjetër ka përzgjedhur një model alternativ. Ajo ka vendosur përgjegjësinë kryesore për sigurinë e digave tek pronarët/shfrytëzuesit, ndërkohë që shteti nëpërmjet prefektëve ushtron kontroll të mirëfilltë administrativ.

Tab. nr. 14 Krahasimi i modeleve institucionale të kontrollit mbi sigurinë e digave

Shteti	Autoriteti	Kush Rregullon Çfarë	Baza Ligjore & Sistemi i Klasifikimit	Trupat teknike	Planifikimi i Emergjencave & Koordinimi	Vërejtje/Karakteristi ka Kryesore
SHBA	Federal: FERC (për digat e licencuara), USACE & USBR (digat federale); Federal Emergency Management Agency koordinon <i>Programin Kombëtar të Sigurisë së Digave (NDSP)</i>	Agjencitë federale rregullojnë digat federale dhe të licencuara; Shtetet rregullojnë digat jo-federale përmes programeve shtetërore	Akti Federal për Sigurinë e Digave; <i>Federal Guidelines for Dam Safety</i> (FEMA); ligje dhe klasifikime shtetërore sipas potencialit të rrezikut	ASDSO, USSD (Shoqata Amerikane e Digave) ofrojnë udhëzime teknike	EAP (Planet e Veprimit Emergjent) të detyrueshme nën FERC; NDSP mbështet trajnimin dhe koordinimin	Model federal - shtetëror i shtresëzuar , me mbështetje teknike dhe financiare për programet shtetërore.
AU (NSW) ³⁰	Rregullator i pavarur shtetëror Dams Safety NSW	Rregullon “ digat e deklaruar ”; pronarët duhet të mbajnë Sisteme të Menaxhimit të Sigurisë dhe të raportojnë rishikimet	<i>Dams Safety Act 2015</i> dhe <i>Regulation 2019</i> ; klasifikim sipas rrezikut / pasojave	ANCOLD lëshon udhëzime kombëtare (jo-qeveritare) të pranuar nga rregullatorët	Pronarët përgatisin plane emergjence; rregullatori i auditon dhe ndëshkon shkeljet	Sistem i decentralizuar , çdo shtet rregullon, por ANCOLD siguron standardizim teknik
CH ³¹	Zyra Federale për Energjinë (SFOE)	Federata mbikëqyr digat e mëdha me rrezik të lartë; kantonet mbikëqyrin digat e vogla	Ligji Federal për Shfrytëzimin e Energjisë Ujore; klasifikim sipas rrezikut	Njësi teknike brenda SFOE; bashkëpunim me universitete	Koordinim federal-kantonal për përmbytje dhe emergjenca	Model i ndarë , me udhëheqje federale dhe përgjegjësi të kantonëve për nivele më të ulëta
FR ³²	Ministria e Tranzicionit Ekologjik; zbatimimi përmes	Pronarët përgjegjës për sigurinë; shteti autorizon dhe kontrollon	Dekreti 2015-526 (klasa A–C); pjesë e	CFBR (Komiteti Francez i Digave dhe Rezervuarëve	Planet e emergjencës të integruara në urdhëresat e prefektëve	Regjim i fortë ligjor , me përgjegjësi të pronarit dhe kontroll administrativ

³⁰ Australia (New South Wales).

³¹ Zvicër.

³² Francë.

	Prefektëve Rajonalë	sipas klasifikimit	<i>Kodit të Mjedisit</i>	e) jep mendime teknike	dhe planifikimin e përmbytyjeve	
IT ³³	DG Dighe ³⁴ nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit (MIT)	Mbikëqyr të gjitha “ digat e mëdha ”; miraton projektim, ndërtim, funksionim dhe masa sigurie	Ligji nr. 584/1994 dhe aktet nënligjore; standarde teknike nga DG Dighe; Direktiva e Mbrojtjes Civile 2014 për emergjenca	Njësi teknike të DG Dighe dhe ekspertë inxhinierikë	Mbrojtja Civile integron planet e emergjencës në nivel baseni	Model i centralizuar , me drejtori teknike të forta dhe regjistër unik kombëtar
AL ³⁵	ALBCOLD (Komiteti Shqiptar për Diga të Mëdha) – organ kolegjal nën Këshillin e Ministrave , i vendosur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ; buxheti akordohet përmes MIE	Mbikëqyr digat e mëdha dhe ato me rrezik për palë të treta; pronarët/operatorët janë përgjegjës për mirëmbajtje dhe raportim.	Ligji nr. 8681/2001 “Për Projektimin, Ndërtimin, Funksionimin, Sigurinë dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave” + VKM nr. 147/2004 “Për Rregulloren e Sigurisë së Digave”.	KTPD (Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave) & SKDM (Sekretariati Kombëtar i Digave); mbështetje teknike dhe administrative.	Koordinimi me Mbrojtjen Civile parashikohet, por zbatim i është i pjesshëm; pak diga kanë plane emergjence (EAP).	Kornizë ligjore ekzistuese , por kapacitete të kufizuara ; Inspektorati i Digave (ITD) jo-funksional; bashkitë / përdoruesit lokalë kanë burime të pamjaftueshme.

Burimi: Të dhëna të marra nga faqet zyrtare të institucioneve

Përpunoi: GA

Në ngjashmëri me vendin tonë, Italia³⁶ ka një model të centralizuar, me një Drejtori të Përgjithshme të Digave dhe Infrastrukturave Hidrike të vendosur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, e cila mbikëqyr të gjitha digat, miraton projektet e digave, mbikëqyr ndërtimin, funksionim dhe masat sigurisë së tyre. Në ndryshim nga vendi ynë, kjo drejtori në nivel qendror është e organizuar në 8 divizione si vijon:

- Divizioni 1 – Çështje të përgjithshme administrative, koordinim legjislativ dhe çështje gjyqësore;
- Divizioni 2 – Çështje të përgjithshme teknike, koordinimi i sistemit informativ të digave dhe emergjencave;
- Divizioni 3 – Koordinimi i kontrollit të infrastrukturave ujore;
- Divizioni 4 – Koordinimi i kontrollit të digave në ndërtim dhe në fazë prove operimi;
- Divizioni 5 – Koordinimi i kontrollit të digave në shfrytëzim;
- Divizioni 6 – Struktura dhe gjeoteknikë;
- Divizioni 7 – Hidraulikë dhe gjeologji e aplikuar;

³³ Itali.

³⁴ DG Dighe ose në shqip Drejtorja e Përgjithshme e Digave.

³⁵ Shqipëri.

³⁶ https://trasparenza.mit.gov.it/archivio13_strutture -1_14300.html

➤ Divizioni 8 – Planifikimi dhe programimi i ndërhyrjeve në sektorin ujor.

Ndërsa, në nivel rajonal, ajo organizohet në 9 Njësi/Zyra teknike të digave të vendosura në Torino, Milano, Firenze (zyrë shtesë në Perugia), Venezia, Napoli, Palermo (zyrë shtesë në Cosenza) dhe Cagliari, të cilat mbulojnë gjithë territorin e këtij shteti. Çdo divizion dhe zyrë teknike e digave në Itali përbëhet prej ekipeve me inxhinierë dhe ekspertë të fushës, të dedikuar me kohë të plotë në mbrojtjen dhe sigurinë e digave.

Në këtë mënyrë kontrolli i sigurisë së digave është i shpërndarë sa më afër të jetë e mundur me digat e ndryshme, nisur edhe nga fakti se ky shtet ka rreth 526 diga të mëdha.³⁷

Përveç Drejtorisë së Përgjithshme të Digave dhe Infrastrukturave Hidrike, që funksionon dhe kompetenca të njëjta me Komitetin Kombëtar të Digave në Shqipëri, në Itali funksionon edhe Komiteti Kombëtar Italian për Damat e Mëdha. Ndryshe nga KKDM, Komiteti Kombëtar Italian për Damat e Mëdha është një shoqatë kulturore dhe shkencore që ka për qëllim të promovojë dhe të lehtësojë studimin e të gjitha çështjeve që lidhen me damat, ndërtimin dhe funksionimin e tyre.

Në rastin e vendit tonë, modeli i qendëruar/centralizuar i përzgjedhur ka rezultuar i cunguar për disa arsye. Së pari, KKDM është i përbërë nga 11 anëtarë jo me kohë të plotë. KTPD është i përbërë nga 5 anëtarë jo me kohë të plotë. SKMD është i përbërë nga 2 punonjës, ndërsa ITD, i cili ka nisur të funksionojë në tetor 2024 është i përbërë nga 2 punonjës. Pra, për rreth 650 diga të mëdha dhe të jo të mëdha, në vendin tonë ka vetëm 20 individë të dedikuar në këtë fushë, nga të cilët vetëm 4 punonjës janë të angazhuar me kohë të plotë.

Së dyti, duhet theksuar se ky organizim është ideuar dhe miratuar në vitin 2000, kur numri i shfrytëzuesve të digave ishte më i ulët krahasuar me sot. Kjo pasi në vitin 2015 iu transferuan 55 bashkive rreth 600 diga (rreth 300 diga të mëdha dhe 300 të vogla).³⁸ Ky transferim rriti ndjeshëm numrin e shfrytëzuesve të digave duke nxjerrë kështu në pah edhe mangësitë e bashkive në garantimin e një menaxhimi të duhur të këtyre veprave, por edhe pamundësinë e KKDM – së për të ushtruar kontroll pranë të gjithë shfrytëzuesve dhe objekteve në administrim të tyre. Duhet pasur parasysh këtu, se KKDM, sa i takon problematikave të pushtetit vendor, në Raportet Vjetore që harton ka evidentuar vazhdimisht faktin se NJVQV – të nuk kanë kapacitetet e duhura njerëzore dhe financiare për të garantuar dhe mbikëqyrur sigurinë e digave sikundër kërkohet nga baza ligjore/nënligjore në fuqi.

Baza ligjore dhe nënligjore në fuqi paraqet mbivendosje kompetencash në drejtim të ushtrimit të kontrollit fizik mbi digat në vendin tonë.

Organet shtetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e kontrollit dhe sigurisë së digave, sikurse jemi shprehur edhe më sipër janë Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha, Inspektorati Teknik i Digave, Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave, pa përfshirë këtu edhe institucionet e tjera që administrojnë apo shfrytëzojnë digat. Nga analizimi i bazës ligjore/nënligjore ka rezultuar se të gjitha këto institucione janë të përfshira në ushtrimin e kontrollit fizik sa i takon mbrojtjes dhe sigurisë së digave.

Për shembull KKDM bën kontrollin fizik, dokumentar dhe verifikues në diga gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të tyre.³⁹ Po kështu edhe ITD është ngarkuar me kontrollin gjatë ndërtimit, shfrytëzimit e mirëmbajtjes së digave.⁴⁰ Në mënyrë të ngjashme edhe KTPD ushtron kontroll

³⁷ Burimi ICOLD.

³⁸VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”.

³⁹ Neni 4, pika 1, VKM nr. 147, datë 18.03.2004 “Për Miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”.

⁴⁰ Neni 4, pika 3, VKM nr. 147, datë 18.03.2004 “Për Miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”.

të drejtpërdrejtë në diga dhe nën - objektet e tyre⁴¹. SKDM gjithashtu, ka të drejtë të bëjë vizita në terren (për të mbledhur të dhëna mbi digat dhe për të shqyrtuar vartësinë e tyre) jo vetëm pranë institucioneve administruese, por edhe pranë objekteve në terren, duke ushtruar në këtë mënyrë përsëri kontroll mbi digat.⁴² Pra, sikurse mund të vërehet, ligji për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e digave⁴³ si dhe VKM nr. 147, datë 18.03.2004 “Për Miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”⁴⁴ i kanë dhënë kompetencën e ushtrimit të kontrollit fizik në digë të gjitha strukturave që përbëjnë sistemin e krijuar për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e digave, duke krijuar kështu mbivendosje e konfuzion lidhur me përcaktimin e saktë të kompetencave të institucioneve që duhet të ushtrojnë kontroll fizik të digave.

Inspektorati Teknik i Digave, deri në tetor 2024, nuk ka funksionuar dhe nuk ka zhvilluar asnjëherë veprimtarinë e tij inspektuese në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë së digave.

Sipas bazës ligjore shpjeguar më sipër pranë SKDM – së, si pjesë e strukturës së tij, duhet të ngrihet dhe të funksionojë edhe Inspektorati Teknik i Digave. Nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit për digat në vitin 2000 e deri në fund të vitit 2023, Inspektorati Teknik i Digave nuk është krijuar si pjesë e Sekretariatit Kombëtar të Digave të Mëdha. Vetë SKDM është pjesë e strukturës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Me urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 219, datë 13.12.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë” është parashikuar Inspektorati Teknik i Digave, si pjesë e SKDM – së, me 2 punonjës në organikë.

Pavarësisht këtij përcaktimi, struktura e inspektoratit është plotësuar me punonjës në tetor të vitit 2024, kur edhe kjo strukturë ka nisur zyrtarisht të punojë. Kjo situatë ka penalizuar evidentimin e mirëfilltë dhe të planifikuar të shfrytëzuesve të digave, që në vite nuk kanë respektuar bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi sa i takon garantimit të sigurisë së digave që administrojnë, e për rrjedhojë ndaj shkelësve të ligjit nuk është aplikuar asnjëherë asnjë sanksion, sikur parashikohet.

Kontrolli i sigurisë së digave në vendin tonë është kryer pa planifikim të mirëfilltë.

Në mungesë të Inspektoratit Teknik të Digave, KKDM ka ushtruar kontrollin e sigurisë së digave duke u bazuar kryesisht në raportimet që shfrytëzuesit e digave kanë detyrim të bëjnë periodikisht pranë KKDM – së. Në Raportet Vjetore që KKDM harton në lidhje me sigurinë e digave, ka rezultuar që ky organ nuk ka kryer kontrole/inspektime fizike të digave në vendin tonë.

Nga të dhënat në dispozicion nuk ka informacion të saktë e të qartë mbi numrin dhe emërtimin e digave ndaj të cilave planifikohen të zhvillohen kontrole/inspektime në vitin pasardhës. Pavarësisht se KKDM ka miratuar programe vjetore pune, ato konsistojnë në përgatitje të studimeve, vlerësimeve, botimeve, përditësimin e regjistrave të digave, shqyrtime të raporteve vjetore të shfrytëzuesve, përgatitjen e raporteve vjetore për Këshillin e Ministrave etj., rezulton se ky institucion nuk ka kryer planifikim të mirëfilltë të aktivitetit kontrollues në fushën e sigurisë së digave, në veçanti duke pasur parasysh faktin se vendi ynë ka një numër të konsiderueshëm digash (rreth 650 të tilla).

Garantimi i sigurisë së digave në vendin tonë është prioritet, e për këtë arsye KKDM, KTPD, SKDM dhe ITD duhet të planifikojnë natyrën, llojin, frekuencën, subjektin dhe periudhën e

⁴¹ Neni 4, pika 4, VKM nr. 147, datë 18.03.2004 “Për Miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”.

⁴² Neni 4, pika 2, VKM nr. 147, datë 18.03.2004 “Për Miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”.

⁴³ Kreu II, Neni 4, Ligji nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”.

⁴⁴ Neni 4, Organet shtetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e digave/dambave dhe të kontrollit të sigurisë së tyre.

kontrollit/mbikëqyrjes/inspektimit që do të ushtrohet ndaj shfrytëzuesve të digave. Kjo praktikë është në funksion të garantimit të mbulimit me mbikëqyrje të duhur të të gjitha digave të vendit tonë, në varësi edhe të gjendjes në të cilën ato ndodhen dhe nivelit të rrezikshmërisë që ato paraqesin për të tretët.

Sikurse sugjerojnë e praktikatat e mira për shembull në fushën e inspektimeve, në një auditim të kryer nga Zyra e Kontrollorit të Përgjithshëm të Shtetit të New York – ut⁴⁵, evidentohet pikërisht se zyrtarët e Sigurisë së Digave në Shtetin e New York – ut, në vite kanë planifikuar dhe raportuar mbi inspektimet e kryera. Zyrtarët e Sigurisë së Digave në Shtetin e New York-ut kanë argumentuar devijimet nga plani për periudha të caktuara kur funksioni i inspektimit nuk ka garantuar mbulim. Këto informacione janë përmbledhur në një tabelë që pasqyron ecurinë e procesit të inspektimit. Procesi i planifikimit i siguron institucioneve një menaxhim të qartë dhe të saktë të nevojave për kontroll/mbikëqyrje/inspektim duke marrë në konsideratë edhe burimet që ato kanë aktualisht.

Tab. nr. 15 Inspektimet e Sigurisë së Digave, Sipas Vitit Fiskal të Shtetit të New York - ut

Viti Fiskal	Të Planifikuara	Të Raportuara
2000-01	300	372
2001-02	300	447
2002-03	300	477
2003-04	300	(a) ⁴⁶
2004-05	300	(a)
2005-06	300	164
2006-07	300	Në Proces

Burimi: Raport Auditimi i Zyrës së Kontrollorit të Përgjithshëm të Shtetit të New York – ut

Në analogji edhe me ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, në të cilin parashikohet programimi i aktivitetit inspektues, edhe në rastin e institucioneve shtetërore që ushtrojnë kontrollin e sigurisë së digave (qoftë ky kontroll i mirëfilltë, inspektim, monitorim apo mbikëqyrje) nevojitet programim apo planifikim i mirëfilltë i veprimtarisë që do të kryhet e për të cilën institucioni ka detyrim raportimi. Një qasje e tillë do të garantonte mbulim të mjaftueshëm dhe organizim të mirëfilltë të aktivitetit të institucioneve.

AKBN nuk ushtron kontroll dhe monitorime lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë e digave.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në fushën e hidroenergjisë është institucioni shtetëror që garanton monitorimin e kontratave koncesionare të HEC – ve. Nga të dhënat e siguruar nga AKBN, rezulton se 39 operatorë ekonomikë të HEC-eve të ndryshme janë njëkohësisht edhe shfrytëzues të 19 digave. AKBN ka për detyrë të monitorojë vetëm zbatimin e kontratës koncesionare nga operatori ekonomik sa i përket ndërtimit dhe funksionimit të HEC-eve dhe jo monitorimin mbi gjendjen e sigurisë së digave, e cila, siç kemi thënë më sipër, është kompetencë e strukturave të përcaktuara në ligjin për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave.

6. Gjetje nga auditimi: Strukturat përgjegjëse për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e digave nuk kanë ushtruar mbikëqyrje dhe mbulim të plotë me kontroll për të gjitha digat në vendin tonë. Nga auditimi ka rezultuar se KKDM nuk evidenton dhe nuk raporton në Raportet vjetore të tij numrin e saktë të digave të kontrolluara/inspektuara për çdo vit. Për

⁴⁵ Audit Report, Department of Environmental Conservation, Selected Aspects of the Dam Safety Program.

⁴⁶ (a) Sipas zyrtarëve të Sigurisë së Digave, raportet mujore të inspektimeve të kryera nuk u mbajtën për këto vite për shkak të mungesës së stafit.

ushtrimin e kontrollit të rreth 650 digave në vendin tonë angazhohen Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, Komiteti i Përhershëm Teknik i Digave, Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha si dhe Inspektorati Teknik i Digave. KKDM si organ kolegjal ka në përbërjen e tij 11 anëtarë të angazhuar me kohë të pjesshme të cilët mblidhen 1 herë në muaj. Komiteti i Përhershëm Teknik i Digave përbëhet nga 5 anëtarë të përzgjedhur nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë të angazhuar gjithashtu me kohë të pjesshme. Ndërsa Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha si dhe Inspektorati Teknik i Digave (ITD) përbëhen respektivisht nga 2 anëtarë me kohë të plotë. Pra, për mbikëqyrjen dhe mbulimin me kontroll të digave në vendin tonë janë të angazhuar vetëm 4 persona në total me kohë të plotë. Në vlerësimin e grupit të auditimit këto struktura (me këtë numër stafi) e kanë thujtë të pamundur të sigurojnë një mbikëqyrje të duhur në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator.

7. Gjetje nga auditimi: Në Ligjin nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” neni 4 dhe në VKM-në nr. 147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, neni 4, ushtrimi i kontrollit fizik të digave në vendin tonë i është përcaktuar disa strukturave të ndryshme. Konkretisht, referuar këtyre akteve, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha bën kontrollin fizik, dokumentar dhe verifikues në diga gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të tyre. Inspektorati Teknik i Digave është ngarkuar me kontrollin fizik gjatë ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së digave. Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave ushtron kontroll të drejtpërdrejtë në diga dhe nën - objektet e tyre. Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha gjithashtu, ka të drejtë të bëjë vizita në terren (për të mbledhur të dhëna mbi digat dhe për të shqyrtuar vartësinë e tyre) jo vetëm pranë institucioneve administruese, por edhe pranë objekteve në terren, duke ushtruar në këtë mënyrë përsëri kontroll mbi digat. Kjo situatë ka krijuar mbivendosje e konfuzion lidhur me përcaktimin e saktë të kompetencave të strukturave që duhet të ushtrojnë kontroll fizik të digave.

8. Gjetje nga auditimi: Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha në fund të çdo viti miraton programin e punës për vitin pasardhës. Pavarësisht miratimit të programeve vjetore të punës, që konsistojnë në përgatitjen e studimeve, vlerësimeve, botimeve, përditësimin e regjistrave të digave etj., rezultojnë se ky institucion nuk ka kryer planifikim të mirëfilltë të aktivitetit kontrollues në fushën e sigurisë së digave. Nga auditimi ka rezultuar se nuk ka informacion të saktë e të qartë mbi numrin dhe emërtimin e digave ndaj të cilave planifikohen të zhvillohen kontrole/inspektime në vitin pasardhës. Mungesa e një planifikimi të tillë nuk garanton një menaxhim të qartë dhe të saktë të nevojave për kontroll dhe inspektim të digave.

Konkluzioni 2: Parashikimi i vetëm katër strukturave përgjegjëse për kontrollin e digave (KKDM, KTPD, SKDM dhe ITD) nuk ka garantuar mbulim të plotë dhe efektiv të rreth 650 digave në vend. Kjo është pasojë e mbivendosjes së kompetencave dhe mungesës së një planifikimi të koordinuar të veprimtarive të kontrollit dhe mbikëqyrjes.

6 - 7.1 Rekomandim: Në kuadër të propozimeve për ndryshime ligjore, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të propozojnë rishikimin dhe riorganizimin e strukturave ekzistuese, përfshirë këtu edhe ndarjen e qartë të kompetencave midis tyre, për t’iu përgjigjur më mirë kontekstit të vendit tonë.

Brenda datës 30.06.2026

8.1 Rekomandim: Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha në programin vjetor të punës të planifikojë saktësisht numrin dhe emrin e digave që do t’i nënshtrohen kontrollit, periudhën e kontrollit etj, për të siguruar mbikëqyrje e mbulim të duhur në të gjitha digat e vendit.

Në vijimësi

4.2 A kanë marrë institucionet përgjegjëse masa organizative, teknike dhe financiare me qëllim shfrytëzimin normal të digave?

4.2.1 A ka rezultuar efektiv kontrolli, monitorimi dhe raportimi lidhur me sigurinë e digave?

Në VKM Nr.147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, neni 32, përcaktohet monitorimi i cili duhet të bëhet në mënyrë periodike mbi gjendjen e sistemeve të shkarkimit, zbrazjes dhe marrjes së ujit, si dhe të zonave të paqëndrueshme në brigjet e ujëmbledhësit (nëse ka të tilla qysh nga faza e zbatimit dhe të shfaqura gjatë shfrytëzimit). Kontrolli vizual konsiston në:

- kontrollin e kurorës së digës, nëse ka ulje, deformime, mbirje pemësh etj.;
- kontrollin e skarpatës së anës së sipërme (sidomos ku ulet niveli i ujit në ujëmbledhës) nëse ka dëmtime të skarpatës, zhvendosje të veshjes mbrojtëse, mbirjes së pemëve etj.;
- kontrollin e skarpatës së anës së poshtme, nëse ka rrjedhje uji, dëmtime të skarpatës, fole kafshësh, mbirje pemësh etj.;
- kontrollin e shkarkuesit, nëse ka bllokime apo ngushtim seksioni nga materiale të ndryshme, erozioni, korozioni etj.;
- kontrollin e shuarësit të energjisë, nëse ka gërryerje apo deformime të ndryshme;
- kontrollin e kontaktit të digës me brigjet, nëse ka rrjedhje, erozion etj.;
- kontrollin e qëndrueshmërisë së brigjeve të ujëmbledhësit, nëse ka rrëshqitje, erozion etj.;
- kontrolli i aftësisë tërheqëse të prurjes maksimale në anën e poshtme të digës, nëse ka ngushtime seksioni, rrëshqitje, ndërtime të pakontrolluara etj.

Kontrolli nëpërmjet matjeve të aparaturave të vendosura në objektet dhe nën - objektet sipas projektit konsiston në matjet e nivelit të ujit në ujëmbledhës, matjet e filtrimeve në anën e poshtme, matjet e niveleve të puseve piezometrike, matjet e presionit të poreve, matjet meteorologjike, matjet gjeodezike, matjet e deformimeve, matjet e deformimit të fugave, matjet e uljeve, matjet e temperaturave, matjet (regjistrimi) e lëkundjeve sizmike (në qoftë se në digë janë vendosur aparatura), matjet e deformimeve të brigjeve (të paqëndrueshme). Në përfundim të kontrollit, shfrytëzuesi harton raportin vjetor të shfrytëzimit të cilin e paraqet në Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha (nëpërmjet Inspektoratit Teknik të Digave). Raporti përmban vrojtimet, matjet, punimet e kryera për mirëmbajtjen dhe eliminimin e dëmtimeve të vogla, grafikët e matjeve, rezultatet e interpretimeve etj. Bazuar në raportet vjetore të shfrytëzuesve të digave, KKDM harton Raporti vjetor për gjendjen, shfrytëzimin, monitorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave të mëdha në Shqipëri.

Grupi i sigurisë teknike të digave është krijuar vetëm për 30 diga të mëdha.

Çdo subjekt që administron diga duhet të krijojë grupin e sigurisë së digave (i cili kryen kontrollin vjetor të digës), me përbërje inxhinierë të specialitetit hidroteknik⁴⁷. Njësia e drejtimit teknik harton dhe plotëson “Regjistrin e shfrytëzimit” për mbikëqyrjet, vrojtimet, matjet, përpunimet e të dhënave dhe interpretimet e tyre. Në regjistër, sipas datave, shënohen ngjarjet gjatë shfrytëzimit të objektit dhe ujëmbledhësit, si mbushjet, zbrazjet, shkarkimet, manovrimet e portave, matjet, kontrollet, incidentet që konstatohen (filtrime, rrjedhje uji, plasaritje etj.), ngjarjet hidrometereologjike të veçanta, lëkundjet sizmike dhe pasojat e tyre, punimet e mirëmbajtjes, përmirësimit dhe riparimet e kryera në objekt, si dhe çdo gjë që vlerësohet se duhet të regjistrohet. Grupi i auditimit kërkoi nga KKDM dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të dhëna mbi funksionimin e grupeve të sigurisë së digave për të gjitha digat që funksionojnë në Shqipëri. Nga përgjigjet zyrtare të MIE-s u konfirmua se grupi i sigurisë së digave është krijuar vetëm për 30 nga 350 diga të mëdha. Sa i përket

⁴⁷ VKM nr.147, datë 18.03.2004, “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”, neni 5 pika 1.

digave të vogla, nuk u vu në dispozicion asnjë informacion as nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe as nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha. Grupi i sigurisë së digave është krijuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për 8 digat që kjo ministri ka në shfrytëzim. Ndërkohë, Bashkitë e Tiranës dhe Beratit nuk kanë krijuar grupin e sigurisë për asnjë prej digave të mëdha që kanë në shfrytëzim.

Kontrolli i digave nuk është kryer i plotë për të gjitha digat në Shqipëri.

VKM nr.147, datë 18.03.2004, “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave” përcakton kryerjen e kontrollit të digave i cili kryhet çdo vit, si dhe në periudha 5 dhe 10 vjeçare. Kontrolli vjetor i digës kryhet nga shfrytëzuesi i digës dhe drejtohet nga grupi i sigurisë së digës sipas nenit 5 kreu I. Kontrolli vjetor bëhet:

- në pjesët mbi ujë të objektit dhe nënobjekteve, për gjendjen funksionale të elementeve ndihmëse, gjendjen e sistemeve të shkarkimit, të zbrazjes dhe të marrjes së ujit, për gjendjen e digës dhe mjedisit rrethues, mbikëqyrjen e filtrimeve në trupin e digës,
- në bazament dhe brigjet e ujëmbledhësit,
- në galeritë e kontrollit dhe drenimit (kur diga ka të tilla), për funksionimin e aparaturave matëse të vendosura në digë, për mënyrat e kryerjes së matjeve, sistemimin dhe përpunimin e tyre, punimet e mirëmbajtjes, të riparimit ose përmirësimit të kryera në digë dhe cilësinë e tyre, gjendjen e dokumentacionit pranë objektit, të regjistrit dhe dosjes së shfrytëzimit, respektimin e dispozitave të organeve kompetente dhe të “Rregullores së shfrytëzimit të digës nga personeli i shfrytëzimit”.

Kontrolli bëhet në prani të shfrytëzuesit, sipas kërkesës së kryetarit të grupit. Për konstatimet e bëra mbahet procesverbal, i firmosur nga të dyja palët, i cili i paraqitet titullarit të dikasterit ose institucionit përkatës. Një kopje i dërgohet zyrtarisht Inspektoratit Teknik të Digave.

Kontrolli 5-vjeçar i digës kryhet nga shfrytëzuesi i digës dhe nga KKDM-ja, për digat që janë vënë në shfrytëzim brenda 10 vjetëve të para, me kërkesat e pikës 1 të këtij neni.

Kontrolli i plotë 10-vjeçar organizohet dhe drejtohet nga KKDM-ja në të gjitha digat që kanë plotësuar 10-vjeçarin e parë dhe më tej përsëri çdo 10 vjet. Përveç elementëve të kontrollit vjetor, kontrollohen edhe pjesët nën ujë të digës. Kontrolli bëhet kur ujëmbledhësi është plotësisht i boshatisur. Kur kërkohet boshatisja e ujëmbledhësit, por e shoqëruar me humbje ekonomike (të energjisë, të ujit të pijshëm etj.), në bashkëpunim me organet qendrore shtetërore, zgjidhet periudha me humbje më të vogla. Kur nga të dhënat lindin dyshime për defekte të pjesëve nën ujë, kontrolli i plotë duhet të kryhet në prani të ujit, duke përdorur kamera televizive zhytëse ose zhytës me skafandër të specializuar. Në pamundësi të kontrollit të mësipërm dhe kur dyshimi është i madh, të zbrazet rezervuari nga uji.⁴⁸

Grupi i auditimit kërkoi evidenca (nga KKDM dhe MIE) lidhur me kontrollet vjetore, 5 vjeçare dhe 10 vjeçare të kryera për të gjitha digat që janë funksionale në Shqipëri. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga MIE rezulton se kontrolli vjetor është kryer për 228 diga të mëdha nga 350 në total. Sa i përket kontrollit 5 vjeçar ai është kryer vetëm për 3 diga të mëdha dhe konkretisht digat e Moglicës, Banjës dhe Ura e Fanit. Lidhur me kontrollin 10 vjeçar ai nuk është kryer për asnjë prej digave të mëdha në Shqipëri. Ndërsa, sa i përket digave të vogla, nuk ka asnjë informacion nga MIE dhe KKDM lidhur me kontrollet vjetore, 5 vjeçare apo 10 vjeçare të ushtruara në këto diga.

Raportet vjetore të KKDM-së kanë mangësi sa i përket të dhënave dhe informacioneve të paraqitura.

Çdo vit KKDM harton Raportin vjetor për gjendjen, shfrytëzimin, monitorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave të mëdha në Shqipëri. Nëpërmjet këtij raporti, KKDM informon Këshillin e Ministrave për gjendjen dhe problematikat e digave të mëdha duke

⁴⁸VKM nr.147, datë 18.03.2004, “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”, neni 37.

përfshirë aspekte të kontrollit dhe monitorimit të tyre.⁴⁹ Nga vet emërtimi i këtij raporti, ai fokusohet ekskluzivisht në digat e mëdha duke mos informuar Këshillin e Ministrave mbi gjendjen dhe problematikat e rreth 300 digave të vogla.

Siç jemi shprehur edhe në shtjellimin e pyetjeve audituese të mësipërme nga shqyrtimi dhe analizimi i raporteve vjetore të Komitetit Kombëtar i Digave të Mëdha për periudhën 2020-2024 sa i përket digave të vogla nuk ka asnjë të dhënë në këto raporte përveç numrit të tyre të përafërt si dhe disa problematikave përgjithësuese të cilat përsëriten në raportet e çdo viti. Raporte vjetore të KKDM-së përpilohen bazuar në raportet vjetore të dërguara nga shfrytëzuesit e digave. Këto nuk pasqyrojnë qartë veprimtarinë e të gjitha strukturave të angazhuara (KKDM, KTPD, SKDM, ITD) në procesin e mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi sigurinë e digave. Më konkretisht, nuk pasqyrohet asgjë sa i përket planifikimit të kontrolleve në terren nga strukturat e mësipërme. Nuk përshkruhet sa kontrolle janë bërë nga vetë këto struktura. Gjithashtu, në këtë raporte KKDM nuk përshkruan në mënyrë të qartë veprimtarinë e saj lidhur me marrjen e vendimeve, si dhe nuk përshkruan procesin e lënies së rekomandimeve për përmirësime të mundshme nga shfrytëzuesit e digave. Për ta ilustruar më qartë qasjen përgjithësuese të KKDM-së në hartimin e raporteve vjetore të saj mund të sjellim shembullin e braktisjes së digave të përshkruar në mënyrë identike në Raportin Vjetor të 2023 dhe Raportin vjetor të 2024. Sikurse mund të lexohet në tabelën më poshtë, KKDM nuk jep të dhëna konkrete mbi numrin e saktë të digave që janë apo duhet të jenë subjekt i procesit të braktisjes së tyre.⁵⁰

Tab nr 16 Krahasimi i Raporteve Vjetore 2023-2024 të KKDM-së

Raporti Vjetor i KKDM 2023	Raporti Vjetor i KKDM 2024
Njëkohësisht, sipas një inspektimi nga KKDM rezulton se afro 10 % e digave të mëdha dhe me se 25 % e digave të vogla nuk përdoren për qëllimin që janë projektuar dhe ndërtuar, për arsye se kanë dalë jashtë funksionit. Gjithashtu, disa bashki që janë shfrytëzues të këtyre digave kanë kërkuar nxjerrjen jashtë funksionit të disa digave të mëdha të administruara prej tyre por pa paraqitur ndonjë projekt apo plan braktisje apo miratim nga Ministria përkatëse. KKDM sugjeron dhe kërkon rivlerësim teknik nga specialistë me eksperiencë në këtë fushë dhe të licencuar të cilët të hartojnë projektin dhe raportin e duhur në përputhje me standardet teknike shqiptare, legjisllacionin në fuqi dhe rekomandimet e ICOLD.	Njëkohësisht, sipas një inspektimi nga KKDM rezulton se afro 10 % e digave të mëdha dhe me se 25 % e digave të vogla nuk përdoren për qëllimin që janë projektuar dhe ndërtuar, për arsye se kanë dalë jashtë funksionit. Gjithashtu, disa bashki që janë shfrytëzues të këtyre digave kanë kërkuar nxjerrjen jashtë funksionit të disa digave të mëdha të administruara prej tyre por pa paraqitur ndonjë projekt apo plan braktisje apo miratim nga Ministria përkatëse. KKDM sugjeron dhe kërkon rivlerësim teknik nga specialistë me eksperiencë në këtë fushë dhe të licencuar të cilët të hartojnë projektin dhe raportin e duhur në përputhje me standardet teknike shqiptare, legjisllacionin në fuqi dhe rekomandimet e ICOLD.

Burimi: KKDM

E njëjta qasje evidentohet edhe në përshkrimin e çështjeve apo problematikave të tjera lidhur me sigurinë e digave, ku në vend që të jepen të dhëna konkrete e të detajuara, flitet në mënyrë shumë të përmblëdhur dhe për më tepër në raport nuk atashohen evidenca për të mbështetur konkluzionet e arritura.

⁴⁹ Raporti vjetor 2024, Për gjendjen, shfrytëzimin, monitorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave të mëdha në Shqipëri, fq 5.

⁵⁰ Sipas VKM-së nr.147, datë 18.03.2004, “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”, neni 38-40 braktisja e digës bëhet nga shfrytëzuesi (nëpërmjet një plani braktisjeje) kur objekti ka humbur funksionin kryesor për të cilin është ndërtuar dhe ose kur ujëmbledhësi është mbushur me materiale të ngurta në atë shkallë, sa objekti humb funksionin.

Grupi i auditimit gjatë vëzhgimit në terren ka evidentuar disa problematika mbi gjendjen e digave të ndryshme.

Grupi i auditimit, bazuar në raportet vjetore të KKDM-së si dhe të dhënat e siguruara nga MIE, MBZHR dhe Bashkitë Tiranë e Berat kreu vëzhgime në terren në 14 diga si më poshtë:

- Digën e Liqenit Artificial – me shfrytëzues UKT
- Digën e Moglicës - me shfrytëzues Devolli HP;
- Digën e Bovillës - me shfrytëzues UKT;
- Digën e Tufinës – me shfrytëzues Bashkia Tiranë;
- Digën e Farkës - me shfrytëzues Bashkia Tiranë;
- Digën Zelaj - me shfrytëzues Bashkia Tiranë;
- Digën e Bilshit - me shfrytëzues Bashkia Berat;
- Digën e Gjirovenës - me shfrytëzues Bashkia Berat;
- Digën e Starovës - me shfrytëzues Bashkia Berat;
- Digën Ullinjas - me shfrytëzues Bashkia Berat;
- Digën Duhanas - me shfrytëzues Bashkia Berat;
- Digën e Thanës - me shfrytëzues DUK Fier;
- Digën e Kurjanit - me shfrytëzues DUK Fier;
- Digën Belesovës - me shfrytëzues DUK Korçë.

Gjatë këtyre vizitave në terren grupi i auditimit u fokusua kryesisht në problematika që kanë të bëjnë me mbajtjen e tyre në kushte optimale me të gjitha elementët e sigurisë, ndërhyrjet për shmangien dhe parandalimin e dëmtimit të tyre dhe pasojat që rrjedhin prej tij, marrjen e masave për braktisjen e digave të cilat kanë kryer ciklin për të cilin janë projektuar dhe kanë humbur qëllimin e tyre etj. Në veçanti, sa i takon braktisjes së digave, është shprehur edhe KKDM në raportet e saj vjetore edhe pse në vija të përgjithshme duke mos specifikuar konkretisht se cilat diga janë/mund të jenë subjekt i braktisjes. Në vijim paraqiten rezultatet e vizitave në terren për secilën prej digave të sipër përmendura.

Diga e Liqenit Artificial të Tiranës


Diga e Liqenit Artificial të Tiranës është ndërtuar në vitet 1957-1958 si pjesë e Parkut të Liqenit Artificial të Tiranës, për të krijuar një kompleks atraktiv për banorët e Tiranës. Ajo përbëhet nga këto vepra kryesore: diga, vepra e shkarkimit, ujëlëshuesi, porta dhe mekanizmat për shkarkimin, kapërderdhësi i prurjeve të tepërta si dhe sifoni i shkarkimit. Kjo është një digë homogjene (dheu), me vëllim të trupit të digës 110,000 m³. Bazamenti i saj është gjysmë shkëmbor (tokë). Lartësia e digës nga kurora deri në pikën më të ulët të gjurmimit është 17 m. Ndërsa gjatësia e kurorës së digës është 600 m.⁵¹

Referuar dokumentacionin në dispozicion, për digën e Liqenit Artificial nuk është plotësuar dokumentacioni i plotë (pasaporta e digës). Në këtë digë nuk ka sisteme monitorimi funksionale për asnjë element të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore, përjashtuar një matësi të nivelit të ujit në mënyrë manuale (latë). Nuk bëhet asnjë monitorim nëpërmjet instrumenteve në lidhje me nivelin e filtrimeve në anën e poshtme, nivelin e puseve piezometrike, nivelin e presionit të poreve, matje metrologjike, gjeodezike, të deformimeve, të uljeve, temperaturës, lëkundjeve sizmike etj. Në mungesë të sistemeve të monitorimit, nuk mund të përshkruhet asnjë element mbi sigurinë e saj nga ana konstruktive, po ashtu edhe të elementëve të tjerë si matja e filtrimeve, presionit të poreve, deformimeve, prurjeve të mëdha etj. Një problematikë e rëndësishme paraqet mos funksionimi i portave të shkarkimit në mënyrë të kontrolluar, pavarësisht se vepra në të cilën janë instaluar portat, funksionon edhe si kapërderdhës (nivele i ujit nuk mund të kalojë atë maksimal, pasi uji shkarkohet nëpërmjet dritareve). Mos funksionimi i portave të shkarkimit bën që në raste fatkeqësish (çarje,

⁵¹ <https://aprtirana.al/parqe-rekreative/parku-i-madh-i-liqenit-tirane/>

deformim apo rritje të rrjedhjeve), shkarkimi i shpejtë i ujit është i pamundur dhe në këtë mënyrë ulet mundësia për shmangie të pasojave ndaj të tretëve. Në veprën e shkarkimit është montuar një sifon prej tubi çeliku. Sasia e ujit që shkarkohet nga ky tubacion është i papërfillshëm në raste emergjente, por mund të përdoret për uljen e nivelit të ujit të liqenit për raste të riparimeve që mund të nevojiten, por koha e uljes së këtij niveli është e konsiderueshme. Në digën e Liqenit Artificial të Tiranës, konstatohen edhe mangësi të cilat kryesisht kanë të bëjnë me mungesë të mirëmbajtjes së strukturës së digës si dhe funksionimin e sistemit të shkarkuesit. Në skarpatat e digës ka bimësi me rrënjë të thella, e cila paraqet rrezikshmëri në lidhje me rritjen e nivelit të filtrimeve të ujit dhe të erozionit të brendshëm.

Foto nr. 1 Pamje nga Diga e liqenit Artificial të Tiranës



Burimi: Grupi i auditimit

Diga e Moglicës

Ndërtimi i digës së Moglicës filloi në vitin 2015 dhe ky hidrocentral filloi funksionimin në vitin 2020. HEC Moglicë shfrytëzon një lartësi prej rreth 300 metra ndërmjet lartësive 650 dhe 350 metra mbi nivelin e detit. Ajo përbëhet nga diga me bërthamë asfalti dhe mbushje me material vendi me një lartësi prej rreth 167 metra e lartë. Rezervuari ka një vëllim total prej rreth 380 milion m³ dhe një sipërfaqe prej rreth 7.2 km².

Bazuar në Vendimin nr. 01, datë 17.01.2022 të KKDM-së, referuar dokumentacionit dhe informacioneve në lidhje me uljet në Digën e Moglicës si dhe rezultatet e monitorimit, kjo digë është në nivelin 2 të alarmit, i cili kërkon planifikimin e punimeve lehtësuese/korrigjuese në digë, si dhe një monitorim të vazhdueshëm dhe të veçantë të të gjithë elementëve të digës. KKDM i ka kërkuar koncesionarit që shfrytëzon digën e Moglicës:

- Dorëzimin pranë KKDM të projektit të ndërtimit sipas faktit.
- Riparimin dhe vënien në punë brenda muajit mars 2022, të inklinometrit MOG-IN-250, i cili që prej tetorit 2020, është jashtë funksioni.
- Marrjen e masave për matjen dhe monitorimin e të gjitha filtrimeve në digë, duke përfshirë edhe filtrimet që dalin nga galeritë.
- Kryerjen e monitorimit të presionit të piezometrave nën pllakat e kapërderdhësit.
- Kryerjen e vrojtimit dhe monitorimit të uljes diferenciale në vendin e bashkimit midis sistemit të shkarkimit të digës.
- Kryerjen e kalibrimit të pajisjeve të monitorimit që janë evidentuar me të dhëna të gabuara. Nga ana e koncesionarit nuk realizohen raportime periodike sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore për digat e mëdha, madje as të dokumentacionit bazë detyrim i plotësimit të pasaportës së digës. Mangësi në raportim nga ana e këtij koncesionari ka edhe në aspektin e zbatimit të marrëveshjes së koncesionit, marrëveshje e cila ka edhe detyrime për elementët e sigurisë së digës.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, nuk mund të konkludohet nëse kërkesat e KKDM-së si më sipër janë realizuar, pavarësisht se nga vizita në objekt me prezencë të punonjësve të AKBN-së, nga ana e koncesionarit pretendohet se janë realizuar.

Në kurorën e digës rezulton një çedim me thellësi mesatare 50 cm, në një gjatësi të konsiderueshme. Çedime të tilla kryesisht vijnë si pasojë e mos respektimit me korrektësi të kushteve të zbatimit në ngjeshjen e shtresave që formojnë digën, por edhe në raste të përdorimit të materialeve jo në përputhje me specifikimet teknike të miratuara si në lidhje me fortësinë, ashtu dhe përbërjen minerale. Uljet e dukshme në kurorën e digës së Moglicës, përbëjnë një element sipas të cilit gabimi mund të jetë prezent edhe në shtresat e bazës së digës, të cilat mund të bëhen më të dukshme me kalimin e kohës dhe në raste të rritjes së nivelit të liqenit në kushtet e prurjeve të mëdha. Për këtë digë janë instaluar disa sisteme të rëndësishme bashkëkohore të monitorimit, si për matjen e presionit në trupin e digës, të matjes së filtrimeve, të temperaturës së brendshme, të matjes së shmangieve, të matjes së lartësisë, kushteve të motit, lëvizjeve tektonike etj., por që nga ana e KKDM-së janë vendosur pikëpyetje për funksionimin e disa prej elementëve të tyre.

Grupi i auditimit i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha me shkresën nr. 22/9 datë 22.09.2025 duke kërkuar informacione mbi zbatimin e detyrave të lëna nga KKDM për shfrytëzuesin e digës, për të cilën nuk ka marrë asnjë përgjigje. Për këtë arsye nuk mund të konkludohet se deri në çfarë mase shfrytëzuesi ka realizuar detyrat e lëna nga Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha.


Foto nr 2 Pamje nga Diga e Moglicës



Diga dhe portat e shkarkimit



Piezometër



Rrëshqitja e kurorës së digës

Burimi: Grupi i auditimit

Diga e Bovillës

Diga e Bovillës është ndërtuar në vitin 1998. Lartësia e digës është 91 m, gjatësia e kurorës së digës 135 m. Qëllimi i ndërtimit të kësaj dige është furnizimi me ujë i Qytetit të Tiranës. Ajo lokalizohet në një distancë 15 kilometër nga qendra e Tiranës. Kjo digë është në administrim të UKT – së.

Bazuar në Vendimin e KKDM-së nr. 03, datë 31.01.2025 “Mbi problematikat e konstatuara në Digën e Bovillës”, gjatë inspektimit të kryer në digë nga KKDM, u konstatua se monitorimi i kësaj dige të madhe mjaft të rëndësishme nuk kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës. Prej shume vitesh në digë nuk është kryer ndonjë monitorim gjeodezik, sizmik, hidrogeologjik dhe gjeologjik me instrumente. Instrumentet e sistemeve të monitorimit të digës janë jashtë funksioni. Ekipi i UKT që administron këtë digë nuk disponon të dhëna të monitorimit me instrumente që prej më shumë se 10 vitesh.

Foto nr. 3 Pamje nga Diga e Bovillës



Piezometër/Inklinometër
Burimi: Grupi i auditimit

Në digë dhe në zonën poshtë saj nuk ka asnjë sistem alarmi për rastet e emergjencave civile, megjithëse kjo digë me lartësi 91 m dhe rezervuar me volum uji mbi 78 milionë m³, konsiderohet vepër e rëndësishme së veçantë. Duke pasur parasysh faktin se poshtë kësaj dige banojnë më se 100 mijë banorë që përfshihen në zonën potencialisht të rrezikuar nga përmbytjet, është emergjent instalimi i një sistemi alarmi bashkëkohor për sinjalizimin në kohë reale të emergjencave civile.⁵²

⁵² Nga intervstat me përfaqësuesit e KKDM- së.

Në anën e djathtë të digës, afro 500 m larg saj, vërehet një çarje e madhe e një masivi shkëmbor, problematika e të cilit është identifikuar prej vitesh nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe UKT, por deri më sot nuk është ndërmarrë asnjë masë për identifikimin dhe monitorimin e madhësisë së kësaj çarje në vite për eliminimin e rrezikshmërisë që mund të ketë për shfrytëzimin dhe sigurinë e Digës.

Diga e Tufinës është ndërtuar në vitin 1965 në shtratin e përroit të Tufinës. Ka lartësinë 23 m dhe gjatësi të kurorës 142 m. Është ndërtuar për qëllim ujitjeje. Nga vëzhgimi në terren i grupit të auditimit është evidentuar se trupi i digës ka pësuar dëmtim në skarpatën e poshtme, duke rrezikuar seriozisht shembjen e plotë të saj. Nga ana e Bashkisë janë marrë masa për mbajtjen nën vëzhgim të saj, duke mos lejuar rritjen e nivelit të ujit në rezervuar, por nuk janë marrë masa për rehabilitim.

Foto nr. 4 Pamje nga Diga e Tufinës



Burimi: Grupi i auditimit

Diga e Farkës është ndërtuar në vitin 1984, ka lartësi 32 m dhe gjerësi të kurorës së digës 310 m. Kjo digë është ndërtuar për krijimin e rezervuarit, për ujitjen e zonave përreth. Nga vëzhgimi në terren i grupit të auditimit është evidentuar se njëri nga shkarkuesit fundorë është jashtë funksionit. Po ashtu, u konstatua se ka dëmtim të shtresës prej betoni të kurorës së digës (kryesisht si pasojë e lëvizjes së mjeteve të tonazhit të rëndë mbi të) si dhe dëmtim të fugave të perdes së betonit të skarpatës së sipërme të digës.

Foto nr. 5 Pamje nga Diga e Farkës



Burimi: Grupi i auditimit

Diga Zelaj, është ndërtuar në shtratin e përroit të Bajsës në vitin 1973. Ka lartësinë 19 m, gjatësi të kurorës së digës 145 m. Është në administrim të Bashkisë Tiranë, Njësia Administrative Baldushk. Nga auditimi u konstatua se është bllokuar shkarkuesi fundor i cili përbëhet prej tub çeliku me diametër 500 mm. Shkarkuesi automatik (tepërplotësi) është

funksional, por është i pa mundur boshatisja e rezervuarit, në raste emergjente, apo nevoje për ndërhyrje në skarpatën e sipërme të digës, apo elementë të tjerë përbërës të saj.

Foto nr. 6 Pamje nga Diga Zelaj



Burimi: Grupi i auditimit

Në Digën e Bilshit rezulton se dy skarpatat janë të mbuluara nga bimësia, e cila është në dimensione të papranueshme. Rrënjët e bimëve mund të depërtojnë në materialin e skarpatës së digës dhe krijojnë rritjen e nivelit të filtrimeve të ujit dhe erozion të brendshëm, sidomos në periudha me nivele të larta të ujit në liqen, fenomen i cili mund të vërë në rrezik vetë qëndrueshmërinë e digës. Në rastin e digave me material vendi, bimësia në skarpatën e poshtme (bimë me rrënjë të sheshta ose me rrënjë të ngjeshura që nuk depërtojnë thellë), ka efekt pozitiv në mbrojtjen nga erozioni sipërfaqësor, por bimësia e çdo lloji në skarpatën e sipërme (ana e liqenit) është e papranueshme.

Më poshtë paraqiten foto të bimësisë në skarpatat e kësaj digë.

Foto nr. 7 Pamje nga Diga e Bilshit



Burimi: Grupi i auditimit

Krahas dëmeve potenciale të bimësisë për vetë formacionin e digës, prania e bimësisë në skarpatat e digës pamundëson realizimin e proceseve të monitorimit të përcaktuara në VKM Nr.147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, neni 32 si dhe Udhëzimin Nr. 12, datë 30.12.2019 “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”, të cilat kanë të bëjnë me:

- Kontrollin e kurorës së digës, nëse ka ulje, deformime, mbirje pemësh.
 - Kontrollin e skarpatës së anës së poshtme, nëse ka rrjedhje uji, dëmtime të skarpatës, fole kafshësh, mbirje pemësh.
 - Kontrollin e kontaktit të digës me brigjet, nëse ka rrjedhje, erozion etj.
 - Kontrollin e qëndrueshmërisë së brigjeve të ujëmbledhësit, nëse ka rrëshqitje, erozion etj.
- Në mungesë të të dhënave të mësipërme, proces i cili nuk mund të realizohet në praninë e bimësisë në nivele të papranueshme, nuk mund të vlerësohet qëndrueshmëria e saj, nuk

mund të vlerësohet risku për ndodhjen e dëmtimeve me pasoja të pariparueshme me dëme si për popullatën ashtu dhe për ekonominë.

Në Digën e Gjirovenës, krahas bimësisë në nivele të papranueshme nga pamjet vizive konstatohet një ulje e kurorës së digës dhe mufatje e skarpatës së poshtme (në mungesë të instrumenteve përkatëse, ky konkluzion nuk ka siguri të plotë). Në rastin e një përcaktimi të saktë, ky fenomen është tepër shqetësues, pasi mund të krijohen plane rrëshqitje të cilat shoqërohen me dëmtim të skarpatës dhe me rrezikim të vetë digës, nëse nuk merren hapat e duhura, në kohën e duhur. Njësoj si për digën e Bilshit, edhe për këtë digë, si pasojë e bimësisë në nivele të papranueshme, nuk mund të realizohen proceset e monitorimit si për kurorën e digës, skarpatave për rrjedhje, erozion, kontrolli për rrëshqitje etj.

Foto nr 8 Pamje nga Diga e Gjirovenës:



Burimi: Grupi i auditimit

Në digën e Starovës rezulton prani bimësie në nivele të papranueshme. Edhe për këtë digë, nuk mund të realizohen disa procese monitorimi, në prani të bimësisë. Në anën e majtë të digës, konstatohen punime në proces ndërtimi, të cilat mund të japin ndikim negativ në formacionet mbështetëse të trupit të digës, duke aktivizuar plane rrëshqitje, rritje të filtrimeve të ujit, sidomos në periudha me lartësi të madhe në liqen.

Foto nr. 9 Pamje nga Diga e Starovës



Burimi: Grupi i auditimit

Diga Ullinjas e ndërtuar për qëllim ujitjeje në vitin 1987 ka lartësi 42 m dhe gjatësi të kurorës 189 m. Dy skarpatat e saj janë të mbuluara nga bimësia, e cila është në dimensione të papranueshme. Në shkarkuesin e plotave (kapërderdhës) kishte ndërhyrje duke e rritur nivelin për lehtësim lëvizje të automjeteve. Rritja e nivelit me lartësi 40 cm, shoqërohet me rritje të nivelit të liqenit me po këtë lartësi mbi nivelin maksimal të projektuar, duke shkaktuar mbingarkesë të digës, sidomos në periudha më reshje të shumta. Mbushja me ujë e liqenit mbi nivelin e lejuar, përveç rrezikut të shtuar për sigurinë e digës, ndikon edhe në dëmtimet që vijnë nga rritje e erozionit të zonës së parashikuar për mbrojtjen nga dallgët. Ndërhyrje të tilla janë shumë të rrezikshme dhe me pasoja të pariparueshme.

Foto nr. 10 Pamje nga Diga Ullinjas



Burimi: Grupi i auditimit

Diga Duhanas është ndërtuar në vitin 1982. Ka lartësi 32 m dhe gjatësi të kurorës 235 m. Kjo digë është ndërtuar për qëllim ujitje. Rezultoi se pellgu është i mbushur me deluvione. Sasia e ujit që mblidhet në rezervuar është e pa mjaftueshme për qëllimin për të cilin është ndërtuar, ujitja. Rritja e mëtejshme e vëllimit të materialeve të precipituara në rezervuar, do të rrisë rrezikshmërinë e bllokimit të shkarkuesit fundor si dhe të shkarkuesit automatik, fenomen i cili shoqërohet me kapërcim të ujit mbi nivelin maksimal të lejuar të digës, si dhe dëmtim të saj. Sa i përket trupit të digës, bimësia në masë nuk lejon as inspektimin më minimal për çarje, devijime apo erozion të dukshëm.

Foto nr. 11 Pamje nga Diga Duhanas



Burimi: Grupi i auditimit

Diga e Thanës, është ndërtuar në vitin 1962. Lartësia e digës është 12 m, ndërsa gjatësia e kurorës së digës është 3481 m. Kjo digë është ndërtuar për qëllim ujitjeje. Nga auditimi u konstatua se janë instaluar instrumente matës si piezometra dhe inklinometra. Pluviometri (matës i sasisë së reshjeve), nuk ishte instaluar në afërsi të digës. Kjo digë ka një gjatësi të konsiderueshme rreth 3.5 kilometër. Në kurorën e digës u konstatuan disa çarje të cilat paraqesin rrezikshmëri për dëmtime të mëtejshme dhe dëmtim të trupit të saj, pasi mund të aktivizohen plane rrëshqitëse në skarpatat e saj. Bimësia është e pranishme si në pothuajse të gjitha digat e inspektuara.

Foto nr. 12 Pamje nga Diga e Thanës



Burimi: Grupi i auditimit

Diga Kurjan është ndërtuar në vitin 1963. Lartësia e saj është 17 m dhe gjatësia e kurorës së digës është 540 m. Burimi kryesor i ujit është rezervuari Kurjan-Strumi. Ky rezervuar furnizohet nga baseni i Lumit Cerveni dhe i lumit Seman nëpërmjet stacioneve të pompimit. Nga vizitat në terren të grupit të auditimit konstatohet se niveli i ujit është poshtë nivelit të lejuar dhe mund të konsiderohet i boshatisur. Tharja e liqenit ka ardhur për arsye të mungesës së reshjeve dhe si pasojë e mënyrës së mbushjes nëpërmjet sistemit të pompimit. Në kurorën e digës konstatohen lehtësisht çarje me dimensione të konsiderueshme të cilat rrezikojnë në aktivizimin e planeve të rrëshqitjes, të cilat rrezikojnë vetë qëndrueshmërinë e digës. Ndryshimi i theksuar i nivelit të ujit në liqen mund të shoqërohet me dëmtim të skarpatës së sipërme, si pasojë e dallgëzimit që krijon uji në shtresa të skarpatës të pa mbrojtura nga dallgët (kryesisht nën nivelin minimal të lejuar).

Foto nr. 13 Pamje nga Diga Kurjan



Burimi: Grupi i auditimit

Diga e Belesovës e ndërtuar për qëllim ujitjeje në vitin 1977, në shtratin e Lumit Belesovë, ka lartësinë 42 m, gjatësi të kurorës 304 m. Nga vizitat në terren të grupit të auditimit rezultoi se kishte precipitim deluvionesh (dherash) në atë masë sa kalon edhe nivelin maksimal të lejuar të mbushjes me ujë, madje ato kishin kapërcyer edhe shkarkuesin automatik (tepërplotësin). Për qëllimin për të cilin është ndërtuar, kjo digë mund të konsiderohet jashtë funksioni. Në trupin e digës janë instaluar instrumente matëse, por marrja e të dhënave nga to, nuk realizohet në mënyrë periodike. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, nuk është marrë asnjë masë në lidhje me procesin e braktisjes së saj. Kjo gjendje dhe opsion është pranuar edhe nga intervistat e zhvilluara me përfaqësuesit e MBZHR-së.

Foto nr. 14 Pamje nga Diga e Belesovës



Burimi: Grupi i auditimit

9. Gjetje nga auditimi: Bazuar në VKM-në për miratimin e rregullores për sigurinë e digave shfrytëzuesit krijojnë grupin e sigurisë së digave. Grupi i sigurisë së digave ka për detyrë të kryejë kontrollin vjetor të digës duke u fokusuar nëse digat janë të dëmtuara, nëse niveli i ujërave arrin pikat kritike në disa zona të matshme dhe nëse lumenjtë kanë dalë jashtë shtratit në përmasa të rrezikshme. Nga auditimi ka rezultuar se grupi i sigurisë së digave është krijuar vetëm për 30 nga 350 diga të mëdha në të gjithë vendin. Sa i përket digave të vogla, nuk u vu në dispozicion asnjë informacion as nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe as nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha. Bashkitë e Tiranës dhe Beratit nuk kanë krijuar grupin e sigurisë për asnjë prej digave të mëdha që kanë në shfrytëzim. Mos krijimi i grupit të sigurisë së digave penalizon kryerjen e procesit të kontrollit vjetor të digës nga shfrytëzuesi.

10. Gjetje nga auditimi: VKM për miratimin e rregullores për sigurinë e digave përcakton kryerjen e kontrollit të digave i cili kryhet çdo vit, si dhe në periudha 5 dhe 10 vjeçare. Kontrolli vjetor i digës kryhet nga shfrytëzuesi i digës. Kontrolli 5-vjeçar i digës kryhet nga shfrytëzuesi i digës dhe nga KKDM-ja. Kontrolli i plotë 10-vjeçar organizohet dhe drejtohet nga KKDM-ja. Nga auditimi ka rezultuar se kontrolli vjetor është kryer për 228 diga të mëdha nga 350 në total. Sa i përket kontrollit 5 vjeçar ai është kryer vetëm për 3 diga të mëdha dhe konkretisht digat e Moglicës, Banjës dhe Ura e Fanit. Lidhur me kontrollin 10 vjeçar ai nuk është kryer për asnjë prej digave të mëdha në Shqipëri. Ndërsa, sa i përket digave të vogla, nuk ka asnjë informacion nga MIE dhe KKDM lidhur me kontrollet vjetore, 5 vjeçare apo 10 vjeçare të ushtruara në këto diga.

11. Gjetje nga auditimi: Çdo vit, KKDM harton Raportin vjetor për gjendjen, shfrytëzimin, monitorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave të mëdha në Shqipëri me të cilin informon Këshillin e Ministrave për gjendjen dhe problematikat e digave të mëdha duke përfshirë aspekte të kontrollit dhe monitorimit të tyre. Nga auditimi ka rezultuar se këto raporte kanë mangësi sa i përket të dhënave dhe informacioneve të paraqitura. Ato fokusohen vetëm në digat e mëdha duke mos informuar Këshillin e Ministrave mbi gjendjen dhe problematikat e rreth 300 digave të vogla. Këto raporte janë kryesisht përmbledhje e raporteve vjetore të hartuara nga shfrytëzuesit e digave e për rrjedhojë ato nuk pasqyrojnë plotësisht veprimtarinë e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha dhe strukturave përbërëse të tij. Në disa raste, për çështje të caktuara, raportet janë përgjithësues dhe përsëritës si për shembull sa i përket braktisjes së digave e cila është përshkruar në mënyrë identike si në Raportin Vjetor të 2023 ashtu edhe në Raportin Vjetor të 2024.

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i grupit të auditimit, në prezencën e përfaqësuesve të Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë si dhe KKDM në Digën e Liqenit Artificial të Tiranës ka rezultuar se Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a nuk kryen monitorim për asnjë element, përjashtuar një matësi të nivelit të ujit në mënyrë manuale. Nuk bëhet monitorim nëpërmjet instrumenteve në lidhje me nivelin e filtrimeve në anën e poshtme, nivelin e puseve piezometrike, nivelin e presionit të poreve, matje metrologjike, gjeodezike, të deformimeve, të uljeve, temperaturës, lëkundjeve sizmike etj., detyrime të përcaktuara në VKM Nr.147, datë 18.3.2004 “*Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave*” Neni 32, pika 2.

- Strukturat e digës nuk mirëmbahen. Si pasojë e daljes nga funksioni të shkarkuesit të ujërave të tepërta (tepërplotësi) në veprën e shkarkimit është montuar një sifon prej tubi çeliku. Sasia e ujit që shkarkohet nga ky tubacion është i papërfillshëm në raste emergjente dhe prurjesh të mëdha. Në raste të paraqitjes së ndonjë defekti apo rrezikshmërie të trupit të digës, ulja e shpejtë e nivelit të ujit në liqen është e pa mundur. Kjo situatë nuk përputhet me kërkesat e VKM-së nr.147, datë 18.3.2004 “*Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave*” Neni 28, pika 3.

- Në skarpatat e digës ka bimësi me rrënjë të thella, e cila paraqet rrezikshmëri në lidhje me rritjen e nivelit të filtrimeve të ujit dhe të erozionit të brendshëm. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion nuk është bërë identifikimi i tyre, në mos përputhje me VKM nr.147, datë 18.3.2004 “*Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave*”, neni 32, pika 1.

13. Gjetje nga auditimi: Në kurorën e digës së Moglicës rezulton një cedim me thellësi mesatare 50 cm, në një gjatësi të konsiderueshme. Cedime të tilla kryesisht vijnë si pasojë e mos respektimit me korrektësi të kushteve të zbatimit në ngjeshjen e shtresave që formojnë digën, por edhe në raste të përdorimit të materialeve jo në përputhje me specifikimet teknike të miratuara si në lidhje me fortësinë, ashtu dhe përbërjen minerale. Uljet në kurorën e digës së Moglicës, të dukshme në kurorën e digës, përbëjnë një element sipas të cilit gabimi mund të jetë prezent edhe në shtresat e bazës së digës, të cilat mund të bëhen më të dukshme me kalimin e kohës dhe në raste të rritjes së nivelit të liqenit në kushtet e prurjeve të mëdha. Në paraqitje, për këtë digë janë instaluar disa sisteme të rëndësishme bashkëkohore të monitorimit, si për matjen e presionit në trupin e digës, të matjes së filtrimeve, të temperaturës së brendshme, të matjes së shmangieve, të matjes së lartësisë, kushteve të motit, lëvizjeve tektonike etj., por që nga ana e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha janë vendosur pikëpyetje për funksionimin e disa prej elementëve të tyre. Bazuar në Vendimin e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha nr. 01, datë 17.01.2022, referuar dokumentacionit dhe informacioneve në lidhje me uljet në Digën e Moglicës si dhe rezultatet e monitorimit, kjo digë është në nivelin 2 të alarmit, i cili kërkon planifikimin e punimeve lehtësuese/korrigjuese në digë, si dhe një monitorim të vazhdueshëm dhe të veçantë të të gjithë elementëve të digës. Për këtë arsye, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha i ka kërkuar koncesionarit paraqitjen e dokumentacionit në lidhje me projektin e ndërtimit sipas faktit, marrjen e masave për matjen dhe monitorimin e të gjitha filtrimeve në digë, duke përfshirë edhe filtrimet që dalin nga galeritë, kryerjen e monitorimit të uljes diferenciale, kryerjen e kalibrimit të pajisjeve të monitorimit etj. Grupi i auditimit i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha me shkresën nr. 22/9 datë 22.09.2025 duke kërkuar informacione mbi zbatimin e detyrave të lëna nga KKDM për shfrytëzuesin e digës, për të cilën nuk ka marrë asnjë përgjigje. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, nga ana e shfrytëzuesit nuk janë marrë masat e plota, për zbatimin e detyrave të lëna nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha. Nga verifikimi i realizuar në Digën e Moglicës nga grupi i auditimit me prezencën e përfaqësuesve të AKBN-së, konstatohet se nga ana e shfrytëzuesit nuk është marrë asnjë masë për riparimin/stabilizimin e cedimit në kurorën e digës.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë, nuk kryen monitorimin e Digës së Bovillës në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës. Instrumentet e sistemeve të monitorimit të digës janë jashtë funksioni. Ekipi i UKT që administron këtë digë nuk disponon të dhëna të monitorimit me instrumente që prej më shumë se 10 vitesh, në kundërshtim me VKM Nr.147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”. Gjithashtu, në digë dhe në zonën poshtë saj nuk ka sistem alarmi për rastet e emergjencave civile, megjithëse kjo digë me lartësi 91 m dhe rezervuar me volum uji mbi 78 milionë m³, konsiderohet vepër e rëndësisë së veçantë. Duke pasur parasysh faktin se poshtë kësaj dige banojnë më se 100 mijë banorë që përfshihen në hartën e përmbytjeve, është emergjent instalimi i një sistemi alarmi bashkëkohor për sinjalizimin në kohë reale të emergjencave civile, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 248, datë 28.01.2000 “Për hartimin e planit të alarmit, evakuimit dhe ndihmës për mbrojtjen e popullatës si pasojë e prishjes së digave dhe dambave”. Ndërsa, në anën e djathtë të digës, rreth 500 m larg saj, vërehet një çarje e madhe e një masivi shkëmbor, problematika e të cilit është identifikuar prej vitesh nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe UKT, por deri më sot nuk është ndërmarrë asnjë masë për identifikimin dhe monitorimin e madhësisë së kësaj çarje në vite për eliminimin e rrezikshmërisë që mund të ketë për shfrytëzimin dhe sigurinë e Digës, detyrime të përcaktuara në VKM Nr.147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, neni 28, pika 3. Kjo situatë konfirmohet edhe nga KKDM në Vendimin e KKDM nr. 03, datë 31.01.2025 “Mbi problematikat e konstatuara në Digën e Bovillës”.

15. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i grupit të auditimit në terren ka rezultuar se skarpatat e digave të Bilshit, Gjirovenës, Starovës dhe Ullinjasit (me shfrytëzues Bashkinë Berat) janë të mbuluara nga bimësia, e cila është në dimensione të papranueshme. Prania e bimësisë në skarpatat e digës pamundëson realizimin e proceseve të monitorimit të përcaktuara në VKM Nr.147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, neni 32 si dhe Udhëzimin Nr. 12, datë 30.12.2019 “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”. Në shkarkuesin e plotave të Digës Ullinjas (kapërderdhës) rezulton se ka ndërhyrje në nivelin e shkarkuesit me 40 cm për të lehtësuar lëvizjen e automjeteve. Rritja e nivelit me lartësi 40 cm, shoqërohet me rritje të nivelit të liqenit me po këtë lartësi mbi nivelin maksimal të projektuar, duke shkaktuar mbingarkesë të digës, sidomos në periudha me reshje të shumta. Mbushja me ujë e liqenit mbi nivelin e lejuar, përveç rrezikut të shtuar për sigurinë e digës, ndikon edhe në dëmtimet që vijnë nga rritje e erozionit të zonës së parashikuar për mbrojtjen nga dallgët. Ndërhyrje të tilla në veprat përbërëse të digave janë shumë të rrezikshme dhe me pasoja të pariparueshme dhe janë në mos përputhje me Udhëzimin e MBZHR nr. 12, datë 30.12.2019 “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”, pika 2.4.

16. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i realizuar në digat e Thanës dhe Kurjanit, në prezencë të përfaqësuesve të Drejtorisë së Ujitje-Kullimit Fier, në cilësinë e shfrytëzuesit të tyre, u konstatua se në trupin e digës ka çarje të cilat paraqesin rrezikshmëri të lartë për aktivizimin e planeve të rrëshqitjeve dhe mund të rrezikojnë vetë digën. Nga ana e Drejtorisë së Ujitje-Kullimit Fier si dhe nga institucionet përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin e digave, nuk janë konstatuar më parë këto defekte, duke arritur në konkluzionin se nuk ka një monitorim periodik të digave.

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit si dhe verifikimi në terren me përfaqësues të Bashkisë Tiranë, ka rezultuar se digat e Tufinës dhe e Belesovës rezultojnë jashtë funksionit për të cilin janë ndërtuar dhe projektuar. Diga e Tufinës është dëmtuar si pasojë e rrëshqitjes së skarpatës, ndërsa diga e Belesovës është mbushur me deluvione. Për

këto diga nuk janë marrë masa për vlerësimin e gjendjes teknike dhe mundësinë e deklarimit të braktisjes, sikundër parashikon VKM nr.147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, neni 38.

Konkluzion 3: Kontrolli, monitorimi dhe raportimi mbi gjendjen dhe sigurinë e digave në vendin tonë vuan mungesën e ngritjes dhe funksionimit të të gjitha strukturave mbikëqyrëse, sistemit të monitorimit dhe raportimit jo të plotë e të qartë. Mungesa e një sistemi alarmi nuk mundëson lëvizjen e popullatës nga zona e përfshirë në hartën e përmbytjeve. Në zona afër digave të vëzhguara nga grupi i auditimit janë konstatuar dëmtime të strukturave të shkëmbinjve, rrëshqitja e të cilave krijon dallgë dhe rritje të menjëhershme të nivelit të ujit të liqenit, duke rrezikuar shkatërrimin e saj. Uljet e kurorave të digave, apo mufatjet e skarpateve përbëjnë rrezik të lartë për aktivizimin e planeve të rrëshqitjeve të cilat bëhen shkak për dëmtimin e plotë të digave. Rrënjët e bimëve mund të depërtojnë në materialin e skarpatës së digës dhe rrisin nivelin e filtrimeve të ujit dhe erozion të brendshëm, sidomos në periudha me nivele të larta të ujit në liqen, fenomen i cili mund të vërë në rrezik vetë qëndrueshmërinë e digës.

9.1 Rekomandimi: Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha së bashku me Inspektoratin Teknik të Digave të planifikojnë dhe inspektojnë të gjithë shfrytëzuesit e digave me qëllim ngritjen dhe funksionimin e grupit të sigurisë së digave. Bashkitë e Tiranës dhe Beratit të marrin masa për të krijuar grupin e sigurisë së digave në përputhje me rregulloren për sigurinë e digave.

Menjëherë

10.1 Rekomandimi: Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha së bashku me Inspektoratin Teknik të Digave të sigurojnë që të gjithë shfrytëzuesit e digave të kryejnë kontrollin vjetor, kontrollin 5-vjeçar dhe atë 10-vjeçar.

Në vijimësi

11.1 Rekomandimi: Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, në Raportet vjetore mbi gjendjen, shfrytëzimin, monitorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave, të pasqyrojë informacion të detajuar mbi veprimtarinë e tij dhe strukturave të tjera të tij (SKDM, KTPD, ITD); të përfshijë informacione të detajuara edhe për digat e vogla; të shmangë qasjen përgjithësuese dhe përsëritëse në përshkrimin e problematikave mbi sigurinë e digave si dhe të pasurojë raportet vjetore me shtojcat përkatëse.

Në vijimësi

12.1 Rekomandimi: Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, të vendosë në funksion shkarkuesin e ujërave të tepërta si dhe të implementojë sisteme të monitorimit për të garantuar qëndrueshmërinë e digës së Liqenit Artificial të Tiranës dhe shmangien e katastrofave që vijnë nga dëmtimi i mundshëm i saj.

Brenda datës 30.06.2026

12.2. Rekomandimi: Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a të planifikojë dhe realizojë investime për mirëmbajtjen periodike të trupit të digës së Liqenit Artificial të Tiranës dhe elementëve përbërës të saj, duke filluar nga heqja e bimësisë me rrënjë të thella.

Brenda datës 30.06.2026

13.1. Rekomandimi: Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha në bashkëpunim me Inspektoratin Teknik të Digave të sigurojnë zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha nr. 01, datë 17.01.2022 për të riparuar cedimet dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e digës së Moglicës.

Brenda datës 31.03.2026

14.1. Rekomandimi: Ujësjetës-Kanalizime sh.a. Tiranë të instalojë instrumente të nevojshëm të alarmit dhe monitorimit mbi sigurinë e digës së Bovillës; të realizojë studime me qëllim programimin dhe realizimin e investimeve për stabilizimin e rrëshqitjes së shkëmbinjve.

Brenda datës 30.06.2026

15.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa për realizimin e sistemeve të monitorimit për digat në administrim të saj. Në të gjitha digat në administrim të saj të realizojë inspektime për përcaktimin e shkallës së dëmtimit të tyre si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes dhe marrjen e masave për riparimin dhe vendosjen e tyre në kushtet teknike të pranueshme.

Brenda datës 30.06.2026

16.1. Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me Drejtorinë e Ujitje-Kullimit Fier të marrin masa të menjëhershme për realizimin e studimeve përkatëse për përcaktimin e planeve të rrëshqitjes dhe riparimin e tyre, me synim parandalimin e dëmtimit të mëtejshëm, i cili mund të rrezikojë dëmtimin e plotë të digave dhe shkaktim të dëmeve ndaj palëve të treta.

Menjëherë

17.1. Rekomandimi: Bashkia Tiranë dhe Drejtoria e Ujitje-Kullimit Korçë, respektivisht për digat e Tufinës dhe Belesovës të vlerësojnë gjendjen teknike të tyre duke marrë në konsideratë mundësinë e braktisjes në rast se ato nuk mund të përmbushin më qëllimin për të cilin janë projektuar dhe ndërtuar.

Brenda datës 30.06.2026

4.2.2 Çfarë masash janë marrë lidhur me përmirësimin e gjendjes teknike të digave?

Sikurse është përmendur edhe më sipër, Shqipëria renditet ndër gjashtë vendet e para në Evropë dhe në vendin e 19 në botë për numrin total të digave të mëdha. Gjithashtu në Evropë, vendi ynë është shteti që ka numrin më të lartë të digave të mëdha për frymë për 1000 km². Konkretisht, vendi ynë ka 351 diga të mëdha dhe rreth 300 diga të vogla, të cilat janë ndërtuar kryesisht në vitet 1957 – 1990, pa përjashtuar këtu edhe disa diga të mëdha si për shembull Diga e Moglicës etj. të cilat janë ndërtuar në pas viteve 90. Referuar të dhënave të paraqitura nga KKDM në Raportet Vjetore, më shumë se 90% e digave në total dhe 45% e digave të mëdha janë ndërtuar para viteve 1990⁵³, në periudha kur sipas standardeve të projektimit të kohës jetëgjatësia mesatare e këtyre veprave duhet të ishte rreth 50 – 60 vjet. Ky fakt vendos në fokus nevojën për marrjen e masave të përshtatshme për të përmirësuar situatën aktuale të këtyre veprave, pasi ato kanë rëndësi ekonomike të veçantë për vendin tonë, por edhe njëkohësisht përbëjnë risk të lartë për dëme ndaj të tretëve në rast prishjeje të mundshme të tyre apo në situata përmbajtjes nga reshjet e mëdha.

Sipas Regjistrimit Kombëtar të Digave të Mëdha të hartuar dhe miratuar nga KKDM (i përditësuar në vitin 2024), në totalin e 351 digave të mëdha të vendit tonë:

- 28 diga të mëdha përdoren kryesisht për prodhim energjie ujore;
- 317 diga të mëdha përdoren kryesisht për qëllime ujitje te tokave (rezervuarët e 130 prej tyre përdoren edhe për peshkim);
- 4 diga të mëdha përdoren kryesisht për qëllime urbane dhe turistike;
- 2 diga të mëdha përdoren për furnizim me ujë të pijshëm.

Digat e mëdha administrohen dhe përdoren nga 67 operatorë të ndryshëm, ku:

- 1 operator është operator publik shtetëror (KESH sh.a.), që administron 6 digat e kaskadës së lumit Drin, të cilat përdoren kryesisht për prodhim energjie. Tre

⁵³ Raportet Vjetore KKDM 2021 – 2024.

rezervuarët e krijuar prej këtyre digave përdoren gjithashtu për turizëm, transport ujqor, ujitje të tokave bujqësore në zonën e Shkodrës dhe peshkim.

- 1 operator është operator publik shtetëror (MBZHR), që administron 8 diga të mëdha, të cilat përdoren kryesisht për ujitje, por 2 prej rezervuarëve të krijuar prej tyre përdoren edhe për prodhim energjie nga operatorë privatë që i kanë marrë me koncesion. Gjithashtu, MBZHR ka nën administrim edhe kompleksin hidroteknik të Ashtës, të përbërë nga një argjinaturë mbrojtëse me gjatësi mbi 2 600 m, e cila krijon një rezervuar uji me volum prej më se 2 milionë m³. Ky kompleks shfrytëzohet për prodhim energjie nga kompania austriake Verbund, si dhe për ujitjen e tokave bujqësore në rrjedhën e poshtme të lumit Drin, duke përfshirë edhe zonën e Vaut të Dejës.
- 1 operator është operator privat (KURUM sh.p.k.), që përdor 3 diga të mëdha dhe një kanal derivacioni në Bistricë, me anë të të cilave shfrytëzon në formë kaskade ujërat e lumenjve Mat dhe Bistricë për prodhim energjie.
- 7 operatorë janë operatorë privatë që i kanë marrë me koncesion për prodhim energjie ujore (Devolli HP, AYEN, Inerte Lumzi, Diteco, Teodori 2003, Hydroenergy, Favina).
- 2 operatorë të digave të mëdha që përdoren për furnizimin me ujë janë ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizimeve Durrës (UK Durrës) dhe Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë (UK Tiranë).

Gjithashtu, 55 operatorë të tjerë të digave të mëdha janë bashkitë në të gjithë vendin, të cilat administrojnë:

- 323 diga të mëdha për ujitje, peshkim, qëllime urbane dhe turistike;
- si dhe afro 300 diga të vogla, të cilat u janë transferuar atyre me VKM nr. 1108, datë 30.12.2015, “Për Transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të Personelit dhe të Aseteve të Luajshme e të Paluajshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”.⁵⁴

Bashkitë Tiranë dhe Berat nuk kanë kryer investime të mjaftueshme për të përmirësuar gjendjen e të gjitha digave që kanë në shfrytëzim.

Operatorët e ndryshëm, qofshin ata publikë apo privatë, që administrojnë dhe përdorin digat, në kuptimin e ligjit për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e digave, quhen shfrytëzues të këtyre veprave. Pikërisht në periudhën e shfrytëzimit të digave duhet të parashikohen dhe të kryhen ndërhyrje të ndryshme për të riparuar dhe përmirësuar kushtet e digave⁵⁵ sipas nevojave specifike të tyre. Në këtë drejtim, shfrytëzuesi i veprës/objektit është subjekti përgjegjës, ndër të tjera, për të mirëmbajtur objektin në përputhje me kërkesat teknike miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe KKDM – ja, si dhe për të mbuluar të gjitha shpenzimet që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen, riparimin, përmirësimin dhe gjithë veprimtaritë që lidhen me sigurimin e digës dhe të tretëve.⁵⁶ Pra, në këtë drejtim shfrytëzuesit e digave duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të përmirësuar gjendjen teknike të digave që kanë në shfrytëzim, përfshirë këtu në veçanti parashikimin e buxhetit/eve të nevojshëm për këtë qëllim. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga subjektet, sa i takon investimeve të kryera për përmirësimin të gjendjes së digave që shfrytëzuesit kanë aktualisht, ka rezultuar se në totalin prej rreth 650 digave janë bërë ndërhyrje të ndryshme vetëm në 43 diga.⁵⁷ Këto ndërhyrje janë financuar kryesisht nëpërmjet Programit Buxhetor "Menaxhimi i

⁵⁴ Raport Vjetor KKDM 2024.

⁵⁵ Neni 7, Ligji nr. 8681, datë 2.11.2000 “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”.

⁵⁶ Neni 8, germa b dhe c, Ligji nr. 8681, datë 2.11.2000 “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”.

⁵⁷ Aneksi I i këtij raporti - Lista e investimeve të kryera për periudhën 2016 – 2024.

infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes”, fondeve të Bankës Botërore, dhe fondit për digat nëpërmjet Programit Buxhetor “Emergjencat Civile” të Ministrisë së Mbrojtjes. Më konkretisht, për periudhën 2016 – 2019 Banka Botërore ka financuar rehabilitimin dhe përmirësimin e 11 digave (tabela nr 17). Ky financim është alokuar nëpërmjet Programit Buxhetor "Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes”.

Tab. nr. 17 Rehabilitimi i Digave me fonde të BB në Prog. Buxhetor "Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes” për periudhën 2016 – 2019.

Shfrytëzuesi	Diga	Emërtimi i Projektit	Vlera në lekë (fakt)
Bashkia Has	Tregtan 2	Rehabilitim, Përmirësim	26,095,937
Bashkia Has	Tregtan 3	Rehabilitim, Përmirësim	31,723,825
Bashkia Has	Vranisht 2	Rehabilitim, Përmirësim	66,768,293
DUK Fier	Murriz- Thana	Rehabilitim, Përmirësim	318,107,948
Bashkia Patos	Zharrëz	Rehabilitim, Përmirësim	89,559,017
DUK Fier	Kurjan	Rehabilitim, Përmirësim	17,831,400
DUK Fier	Strum	Rehabilitim, Përmirësim	8,956,760
DUK Korçë	Belesovë	Rehabilitim, Përmirësim	84,785,894
Bashkia Berat	Duhas	Rehabilitim, Përmirësim	111,534,734
Bashkia Devoll	Koshnicë	Rehabilitim, Përmirësim	286,100,047
Bashkia Maliq	Leminot	Rehabilitim, Përmirësim	64,236,120
TOTAL			1,105,699,975

Burimi: MBZHR,

Përpunoi: GA

Për periudhën 2019 – 2020, nëpërmjet programit buxhetor “Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes” të MBZHR-së është financuar rehabilitimi i 14 digave si më poshtë.

Tab. nr. 18 Rehabilitimi i Digave me fonde të Prog. Buxhetor "Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes për periudhën 2019 – 2020.

Shfrytëzuesi	Diga	Projekti	Vlera në lekë (fakt)
Krujë	Tapizë	Rehabilitim	204,044,902
Mat	Shoshaj	Rehabilitim	21,756,552
Roskovec	Kurjan	Rehabilitim	24,657,594
Kamëz	Paskuqan	Rezervuari Paskuqan	111,327,896
Pukë	Kukaj	Rehabilitim	18,846,895
Durrës	Arapaj 1	Rehabilitim	19,396,594
Durrës	Spitallë	Rehabilitim	12,114,862
Rrogzhinë	Okshtun	Rehabilitim	46,000,000
Dibër	Gramë	Rehabilitimi	56,226,732
Dropull	Kakavijë, Likomil, Peshkëpi, Bodrisht	Rehabilitim	35,893,178
Tiranë	Rezervuari Gjyslikonjë	Reabilitim i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anësor të rezervuarit Gjyslikonjë.	41,307,550
TOTAL			591,572,755

Burimi: MBZHR,

Përpunoi: Grupi i auditimit

Për periudhën 2020 – 2021, nëpërmjet programit buxhetor "Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes” të MBZHR-së është financuar rehabilitimi i digës së rezervuarit Shkodër, ndërsa për vitet 2022 dhe 2023 nuk ka pasur fonde të alokuara në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës së digave.

Tab. nr. 19 Rehabilitimi i Digave me fonde të Prog. Buxhetor "Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes për periudhën 2020 - 2021

Shfrytëzuesi	Diga	Projekti	Vlera në lekë (fakt)
MBZHR (DUK Lezhë)	Rezervuari i digës Shkodër	“Rehabilitimi i digës së rezervuarit Shkodër” Shkodër.	28,267,038

Burimi: MBZHR,

Përpunoi: Grupi i auditimit

Për periudhën 2024 – 2026, nëpërmjet programit buxhetor "Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes” të MBZHR-së është financuar vetëm rehabilitimi i ushqyesit të rezervuarit të Bllacës.

Tab. nr. 20 Rehabilitimi i digës së Bllacës me fonde të Prog. Buxhetor "Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes për periudhën 2024 – 2026

Shfrytëzuesi	Diga	Projekti	Vlera në lekë (fakt)
MBZHR (DUK Durrës)	Bllacë	“Rehabilitimi i ushqyesit të rezervuarit të Bllacës dhe rehabilitimi i rezervuarit të Bllacës (burimi ujqor)”.	257,289,671

Burimi: MBZHR,

Përpunoi: Grupi i auditimit

Ndërhyrjet financiare për të përmirësuar infrastrukturën e digave nuk kanë qenë të qëndrueshme në kohë, pasi ato kanë munguar totalisht për periudhën 2022 – 2023, përgjatë të cilës shfrytëzuesve të digave nuk i janë ofruar instrumente financiarë në mbështetje të digave. Gjithashtu, evidentohet në këtë drejtim mungesë angazhimi financiar nga shfrytëzuesit, në veçanti nga bashkitë subjekt auditimi për të përmirësuar gjendjen e digave që ato kanë në shfrytëzim. AKMC, në vitin 2024 ka publikuar shpalljen për të financuar shfrytëzuesit e digave për përmirësimin e gjendjes së tyre nëpërmjet fondit për digat në një vlerë totale prej 500 milionë lekë. Nëpërmjet këtij fondi janë financuar vetëm 14 bashki, të cilat kanë përfituar financim në vlerën totale prej 499,894,715 lekësh, (tabela nr 21). Në veçanti, Bashkia Berat nuk ka aplikuar asnjëherë për të përfituar fonde apo investime me qëllim përmirësimin e infrastrukturës së digave, sikundër edhe nuk ka parashikuar investime me fondet e veta për përmirësimin e gjendjes së digave që ka në shfrytëzim. Ndërkohë Bashkia Tiranë, në shkurt të vitit 2024 ka aplikuar për të përfituar fonde nga Fondi për Digat pranë AKMC – së për projektin me objekt “Rikonstruksioni i digës së rezervuarit të Farkës”. Referuar shkresës së KKDM-së me nr 15 prot. datë 31.01.2024, në Bashkinë Tiranë krahas digës së Farkës, digat e mëdha me nevojë urgjente për ndërhyrje rehabilituese janë diga e Kasharit dhe ajo e Cekrezës.

Tab. nr. 21 Rehabilitime përmes Fondit të Digave të AKMC-së

Shfrytëzuesi	Diga	Projekti	Vlera në lekë (fakt)
Mallakastër	Gadurovë	Punime për rehabilitimin e digës së rezervuarit të Gadurovës	81,159,283
Kuçovë	Goraj	Rehabilitimi i digës Goraj.	53,112,034
Vorë	Gjokaj 1	Rehabilitim i digës së rezervuarit Gjokaj 1	21,345,594
Has	Helashan 2	Rehabilitim me qëllim mbi ngritje e digës së rezervuarit “Helashan 2”	48,595,670
Tropojë	Zherka 1 – 2, NJA Fjerzë	Rehabilitimi i ujëmbledhësit Zherka 1-2 dhe i ujëmbledhësit degë, NJA Fjerzë.	18,745,977
Përmet	Qilarisht	Rehabilitimi i rezervuarit Qilarisht	29,776,463
Klos	Bejn	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Bejn 1	54,228,411

Korçë	Gjonomadhit	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit të Gjonomadhit	15,532,056
Këlcyrë	Këlcyrë	Rehabilitim i rezervuarit Këlcyrë	19,238,874
Finiq	Karroq	Rehabilitim i shkarkuesit katastrofik të digës së rezervuarit Karroq	26,837,271
Fushë-Arrëz	Iballë	Rehabilitim i digës së rezervuarit Iballë	59,417,849
Shijak	Bilalaj	Rehabilitimi i rezervuarit të digës Bilalaj	5,187,917
Belsh	Belsh	Punime për rehabilitimin dhe rritjen e sigurisë së digës Belsh dhe pastrimin e kanalit të shkarkimit (vaditëse)	47,340,330
Tiranë	Farkë	Rikonstrukcioni i digës së rezervuarit të Farkës	19,376,986
TOTAL			499,894,715

Burimi: MBZHR

MBZHR, në 4 digat e saj të rehabilituara ku janë vendosur pajisje monitoruese, nuk interpreton dhe përdor të dhënat e përfituara prej tyre për të vlerësuar gjendjen e këtyre digave.

Sipas Raportit Vjetor të MBZHR – së për vitin 2021 (për digat që ajo ka në administrim), i përgatitur nga grupi i sigurisë së digave në MBZHR⁵⁸ dhe dërguar KKDM – së, rezultoi se nëpërmjet Programit Buxhetor "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes", përveç ndërhyrjeve rehabilituese në 12 diga të rehabilituara (digat Thanë, Kurjan – Strum, Divjakë, Belesovë, Koshnicë, Vranisht, Tregan 2 dhe 3, Zharrëz, Duhanas dhe Janjar), janë instaluar edhe instrumente dhe pajisje monitoruese. Sipas këtij raporti, në këto diga janë instaluar pika fikse vrojtimi, reperë, matës në formë V në tubacionet e drenazheve, pieziometër, inklinometër, matës të nivelit të ujit, pluviometër dhe pajisje sinjalizuese të lëvizshme. Instrumentet e mësipërme i janë dorëzuar DUK – ve dhe bashkive përkatëse si dhe janë kryer trajnimet përkatëse të stafit. Nga vizitat e kryera nga grupi i auditimit në terren në digat e MBZHR-së (digat e Belesovës, Kurjan-Strum dhe Thanës) rezultoi se pluviometri⁵⁹ nuk ishte i pozicionuar në digë, por respektivisht në zyrat përkatëse të DUK-ve (DUK Korçë dhe DUK Fier) të cilat janë dhjetëra kilometra larg nga digat. Vendndodhja e instrumentit matës në një distancë të konsiderueshme nga digat, ka penalizuar procesin e monitorimit me instrumente. Arsyeja kryesore e mos pozicionimit të pluviometrave pranë digave të MBZHR – së është për arsye sigurie. Përfaqësuesit e DUK – ve Korçë dhe Fier konfirmuan grupit të auditimit se nuk mund të garantojnë sigurinë e instrumenteve nga keqpërdorues të ndryshëm, nëse ato vendosen pranë digave. Kjo pajisje duhet të vendoset pranë digës në mënyrë që të përmbushë funksionin e saj.

Gjithashtu, nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga DUK Korçë sa i takon matjeve të kryera nga inklinometri dhe pluviometri, rezultoi se këto të dhëna dërgohen në MBZHR, por të dhënat nuk interpretohen e për rrjedhojë nuk mund të nxirret prej tyre informacion mbi gjendjen e digave dhe ndryshimet e tyre ndër vite.

Në vendin tonë, për periudhën objekt auditimi, nuk është kryer një vlerësim/studim gjithëpërfshirës mbi gjendjen e digave për të planifikuar ndërhyrje përmirësuese të koordinuara.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga institucionet subjekt auditimi ka rezultuar se në rang vendi ende nuk është realizuar një vlerësim gjithëpërfshirës i cili të evidentojë

⁵⁸ Shkresa nr. 1880, prot., datë 29.03.2022, "Dërgim i Raportit Vjetor mbi Digat në administrim të MBZHR – së", drejtuar Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha.

⁵⁹ Pluviometri është një instrument meteorologjik për të matur sasinë e reshjeve të rëna në një zonë të caktuar për një periudhë kohe të caktuar.

saktësisht gjendje aktuale të digave në vendin tonë. Kjo do të shërbente si pikë nisje për planifikim ndërhyrjesh dhe vendosje prioritetesh nga ana e të gjithë institucioneve të përfshira, në veçanti nga shfrytëzuesit e digave, të cilët bartin edhe përgjegjësinë për të përmirësuar gjendjen e tyre dhe shmangien e dëmeve ndaj të tretëve. Pavarësisht, mungesës së këtij vlerësimi, ka pasur në këtë drejtim iniciativa të pjesshme ndër vite, kryesisht sa i takon digave në fushën e ujitjes dhe kullimit. Sipas MBZHR – së, vlerësimi më i herët është kryer në vitin 2009, me fonde të Bankës Botërore, nëpërmjet të cilit janë studiuar 195 diga të ujëmbledhësve kryesorë që përdoren për ujitje. Ky studim ka përcaktuar edhe nivelin e rrezikut në funksion të disa faktorëve.

Megjithatë, duhet theksuar këtu, se nga viti 2009 e deri në vitin 2022, MBZHR apo edhe institucione të tjera shfrytëzuese nuk kanë marrë masa për të vlerësuar infrastrukturën e digave, në funksion të parashikimit të ndërhyrjeve respektive sipas nevojës dhe riskut që ato mund të përbëjnë për të tretët. Sikurse kemi shpjeguar edhe në shtjellimin më sipër, deri më tani në vendin tonë nuk ka një klasifikim të digave sipas nivelit të riskut që ato paraqesin për të tretët. Si pasojë e kësaj situatë, ndërhyrjet për përmirësimin e gjendjes së digave, nuk janë vlerësuar kundrejt pasojave që ato mund të gjenerojnë si rezultat i gjendjes së digës.

Pra në këtë drejtim, ndërhyrjet për përmirësim janë diktuar më tepër nga nevoja emergjente për përmirësim dhe shmangie të pasojave katastrofike, se sa programimi i mirëfilltë i tyre duke vendosur saktë prioritetet midis digave për ndërhyrje më emergjente dhe atyre që kanë nevojë për ndërhyrje më pak emergjente.

MBZHR, në periudhën 2021 - 2022, ka aplikuar pranë WBIF (Western Balkans Investment Framework), për përfitimin e një fondi grand, rreth 1.5 milion Euro për kryerjen e studimit të para-fizibilitetit për rreth 450 diga. Sipas përgjigjeve zyrtare të MBZHR - së, ky grand është aprovuar dhe është vendosur zbatimi i tij me Bankën Botërore, nëpërmjet një projekti që është aktualisht në proces me emër *“Zhvillimi i Bujqësisë dhe Përshtatja me Ndryshimet Klimatike”*. Projekti nuk është ende në zbatim, por pritet që të nisë brenda vitit 2026. Sipas MBZHR – së, në funksion të përfundimeve/gjetjeve të këtij studimi, si dhe të studimit të bërë me parë për 195 diga e tjera në vitin 2009, do të vijohet me fazat e tjera të studimit të fizibilitetit, hartimit të projekteve të zbatimit dhe kryerjes së punimeve civile për rehabilitimin e një pjese të digave, të vlerësuara si prioritare nga siguria dhe aftësia ujitëse.

Vetëm me përditësimin e studimit/vlerësimin të 195 digave të vitit 2009 dhe përfundimin e studimit/vlerësimin të 450 digave të tjera, mund të themi që do të kemi një panoramë të plotë e të qartë të gjendjes së të gjitha digave në vendin tonë. Në këtë mënyrë do të mund të sigurohet një shpërndarje më e drejtë, më racionale dhe më efiçente e financimeve për përmirësimin dhe rehabilitimin e digave.

Fondi prej 20 milionë lekë për përditësimin e planeve të alarmit për digat e MBZHR – së nuk është alokuar.

Për vitin 2022, në buxhetin e MBZHR (fazë PBA-je) ishin parashikuar 20 milionë lekë për përditësimin e planeve të alarmit, evakuimit dhe mbrojtjes së popullatës në rast të prishjes së digave. Ky fond do të shërbente për hartave të përmblytjeve 3D me 4 skenarë të ndryshëm për shkarkimin e plotave, përfshirë këtu edhe batimetrit⁶⁰ përkatëse të rezervuarve në administrim të MBZHR-së. Gjithashtu, në këtë kuadër do të përgatiteshin edhe projektet përkatëse të sistemeve të monitorimit dhe alarmit për të vijuar më tej me instalimin e pajisjeve përkatëse monitoruese. Nga auditimi u konstatua se, buxheti i parashikuar në fazë PBA-je, nuk u miratua më tej e për rrjedhojë përditësimi i planeve të alarmit dhe hartave të përmblytjeve nuk është kryer. Aktualisht MBZHR, disponon hartat e përmblytjeve me 1 skenar të shkarkimit të plotave vetëm për 195 diga, financiar me projektin e Bankës Botërore

⁶⁰ Studimi batimetrisë është matja dhe hartëzimi i thellësisë së ujit për të kuptuar topografinë nënujore.

në vitin 2009. Sipas MBZHR, përditësimi i planeve të alarmit dhe hartat e përmbytjeve për 195 diga si dhe hartimi *ex novo* i këtyre për të gjitha digat e tjera në fushën e ujitjes dhe kullimit kërkon një angazhim financiar dhe burimesh njerëzore, i cili tejkalon angazhimin e një institucioni të vetëm. Kjo pasi, për realizimin e një iniciative të tillë kërkohen financime të konsiderueshme dhe asistencë teknike e mirëfilltë, qoftë edhe me mbështetje nga jashtë. Sipas MBZHR-së, në këto kushte kjo iniciativë nuk mund të jetë prioriteti i vetëm i MBZHR-së, por duhet që të jetë prioriteti i përgjithshëm i vendit, për të gjitha llojet e digave.

18. Gjetje nga auditimi: Shfrytëzuesit e digave janë përgjegjës për mirëmbajtjen e digave duke mbuluar të gjitha shpenzimet që lidhen me shfrytëzimin, riparimin, përmirësimin dhe gjithë veprimtaritë që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e digave. Nga auditimi ka rezultuar se Bashkia Berat nuk ka parashikuar dhe realizuar investime me fondet e veta për përmirësimin e gjendjes së digave që ka në shfrytëzim. Gjithashtu, kjo bashki nuk ka aplikuar asnjëherë për të përfituar fonde apo investime (buxheti i shtetit apo financime të huaja) me qëllim përmirësimin e infrastrukturës së digave. Ndërsa, Bashkia Tiranë ka aplikuar dhe përfituar financim nga fondi për digat pranë AKMC-së për projektin me objekt “Rikonstruksioni i digës së rezervuarit të Farkës”. Megjithatë, sipas Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha, në këtë bashki janë edhe dy diga të tjera të mëdha (diga e Kasharit dhe ajo e Cekrezës) me nevojë urgjente për ndërhyrje rehabilituese, për të cilat Bashkia Tiranë nuk ka aplikuar për fonde dhe nuk ka parashikuar ndërhyrje rehabilituese me fondet e veta. Mungesa e investimeve me fondet e veta, mos aplikimeve dhe mos përhithjes së fondeve financiare të huaja nuk ka mundësuar përmirësimin e gjendjes së digave që Bashkitë Tiranë dhe Berat kanë në shfrytëzim.

19. Gjetje nga auditimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me anë të projektit të Bankës Botërore në vitin 2013, ka siguruar pajisje dhe instrumente monitorues të cilët duhet të prodhojnë të dhëna të sakta dhe të interpretueshme mbi gjendjen e digave. Nga auditimi ka rezultuar se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk interpreton dhe përdor të dhënat e përfituara prej tyre për të vlerësuar gjendjen e digave të Belesovës, Krujanit, Strumit dhe Thanës. Për më tepër instrumentet monitoruese si për shembull pluviometri, nuk janë të vendosura në afërsi të digave të sipërpërmendura, por mbahen për arsye sigurie në zyrat e Drejtorive të Ujitjes dhe Kullimit -ve të cilat janë disa dhjetëra kilometra larg këtyre digave. Pluviometri duhet të vendoset pranë digës në mënyrë që të përmbushë funksionin e saj. Mos pozicionimi i pluviometrit pranë digave nuk lejon përfundimin e të dhënave të sakta mbi sasinë e reshjeve të rena në një periudhë të caktuar kohore.

20. Gjetje nga auditimi: Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha në Raportin Vjetor të vitit 2024 thekson nevojën për një vlerësim të digave dhe rezervuarëve të tyre, duke përfshirë këtu të gjitha aspektet që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e tyre për dëme të mundshme ndaj të tretëve. Nga auditimi ka rezultuar se, në vendin tonë nuk është kryer një vlerësim/studim gjithëpërfshirës mbi gjendjen e digave për të planifikuar ndërhyrje rehabilituese të koordinuara. Deri më sot, është kryer vetëm një studim i hershëm (në vitin 2009) me fonde të Bankës Botërore, për 195 diga të ujëmbledhësve kryesorë që përdoren për ujitje. Ndërsa, për periudhën 2021 – 2022, MBZHR ka aplikuar pranë WBIF (Western Balkans Investment Framework) për fonde dhe ka përfituar një grand rreth 1.5 milion Euro për kryerjen e studimit të para - fizibilitetit për rreth 450 diga. Ky studim parashikohet të zbatohet nga Banka Botërore nëpërmjet një projekti (i cili ende nuk ka nisur) me emër “Zhvillimi i Bujqësisë dhe Përshtatja me Ndryshimet Klimatike”. Mungesa e një vlerësimi/studimi gjithëpërfshirës për të gjitha digat e vendit nuk ka siguruar një shpërndarje të drejtë, racionale dhe eficiente të financimeve për përmirësimin dhe rehabilitimin e digave.

Konkluzion 4: Gjendja e digave në vite nuk është përmirësuar, duke reflektuar mungesën e investimeve të qëndrueshme dhe vëmendjes institucionale ndaj sigurisë së tyre. Për shkak të planifikimit të pamjaftueshëm strategjik, përdorimit joefikas të pajisjeve monitoruese dhe mosshfrytëzimit të fondeve të huaja, përpjekjet për rehabilitimin e infrastrukturës së digave kanë qenë të kufizuara. Mungesa e një vlerësimi kombëtar gjithëpërfshirës ka rritur rrezikun e dëmtimeve strukturore dhe të pasojave të mundshme për komunitetet dhe mjedisin përreth.

18.1 Rekomandim: Bashkia Tiranë dhe Bashkia Berat të vlerësojnë nevojat për ndërhyrje mirëmbajtëse dhe rehabilituese të digave që kanë në shfrytëzim e bazuar mbi to të bëjnë një planifikim financiar duke aplikuar për fonde dhe mbështetje financiar me qëllim përmbushjen e këtyre ndërhyrjeve.

Në vijimësi

19.1 Rekomandim: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të vendosë pranë digave që ka në shfrytëzim instrumentet monitorues (pluviometrin) dhe të garantojë sigurinë e tyre nga prishjet apo tjetërsimet e mundshme.

Brenda datës 31.03.2026

19.2 Rekomandim: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të interpretojë të dhënat e gjeneruara nga instrumentet monitorues që dërgohen nga DUK-të dhe t'i përfshijë ato në raportimet periodike mbi gjendjen e digave që ka në shfrytëzim.

Në vijimësi

20.1 Rekomandim: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha të vlerësojë mundësinë për të aplikuar dhe përfituar fonde me qëllim përditësimin e studimit/vlerësimin të 195 digave të ujitjes dhe kullimit të realizuar në vitin 2009.

Brenda datës 30.06.2026

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT